



NEWS SOT

Themeluar në 26 Tetor 2002
Çmimi 30 lekë
E Martë 2 Korrik 2024

SIGMA
INTERALBANIAN
VIENNA INSURANCE GROUP

Skandalet e Belinda Ballukut nuk kanë fund, KESH tender 2.1 mln euro energji me çmim më të lartë se në bursë, blerja në platformë të fshehtë, si “avulluan” 400 mijë euro



Faqe 8

Romeo Kara zbulon se çfarë do të ndodhë me përplasjen e Olsi Ramës dhe Gazment Bardhit në dyert e Prokurorisë së Posaçme dhe tregon detaje nga dosja që pritet të hapë SPAK ku dalin mjekë të përfshirë në vrasje, ja detajet e rënda që do të dalin nga skandali më i madh dhe më i pështirë që ka ndodhur këto 33 vite

Faqe 5



Muaj paniku për Ilir Beqajn, më 26 korrik vendoset fati i tij për një nga dosjet që po heton SPAK për abuzimet me koncesionet në shëndetësi, ja aferat e tjera të ish-ministrit që pritet t'i hanë “kokën”, nga pastrimi parave, te zhvatja e parave të projekteve të BE, deri te “ortakët” që përdorte

Faqe 3

Shkëlzen Berisha dhe Argita kanë bërë trafik armësh me Mubarakun, Gadafin e Ben Alinë, ja pse SPAK po bllokoi arrestimin e Ilir Metës, Idajet Beqiri zbardh të dhënat tronditëse nga dosja me 140 faqe në tryezën e prokurorëve

Faqe 2

Hyn në fuqi rritja e pagave për 135 mijë punonjës të administratës publike, ja sa do rriten rrogat për çdo kategori, zbardhet lista e plotë me shtesat, lajme të mira edhe për të moshuarit, pensioni minimal pritet të shkojë 15.000 lekë, çfarë do të ndodhë në vjeshtë

Faqe 10



Faqe 12

Rezoluta për Jasenovacin “tërbon” Bashkimin European, Brukseli nuk e ka vonuar aspak hakmarrjen, ja dy “shuplakat” që mori Mali i Zi brenda 24 orësh, pse Podgorica bëri “autogol” me mbështetjen për Serbinë



Faqe 13

Trump fiton sërish kohë, Gjykata e Lartë vendos për imunitetin e ish-presidentit, ja sa gjasa ka që gjyqi i tij të mbahet para zgjedhjeve, pse manjati ka një shans të artë për t'u shpëtuar akuzave

Skandalet te AKSHI, a është blerë Prokuroria që po heton Mirlinda Karçanajn nga grupet e interesit, si prokurorët po çojnë hetimet drejt kalendave greke

Faqe 9

Arbër Papelekaj dënohet me 7 vite për vrasjen Pjerin Xhuvani, a do ta hetojë Prokuroria Gazment Bardhin si drejtues i strukturës për Mbrojtjen e Votës në Elbasan nga PD

Faqe 4

Ta përdorësh uniformën e mjekut për të nxjerrë para është krim kundër njerëzimit, Rama “dush të ftohtë” drejtuesve të QSUT-së pas skandalit të Onkologjiku, ministrja Albana Koçiu paralajmëron ndryshime të forta në ligj

Faqe 7

KOMENT & ANALIZË

Faqe 16-17

Nga Ali BEQO

Shteti ligjor dhe demokracia në Shqipëri

Nga Saba LAMA

Aktorët përgjegjës, për rezultatet e dobëta në provimet e maturës dhe minimaturës

Nga Enver ÇAKAJ

Kur kujtoj spitalin e vdekjes!

Nga Fatos ÇOÇOLI

Thumanë-Kashar, arteria qendrore e Korridorit Blu

RAJON & BOTË

Fitorja e të djathtës prish ekuilibrat në BE, Macron ka edhe një “as nën mëngë”, çfarë është balotazhi trekëndor që pret Francën, tre blloqe rivale do të përballen në 7 korrik, ja pse këto zgjedhje janë kaq të pazakonta

Faqe 15

Fillon “dyluftimi” në Bruksel, Orban ka nisur një ofensivë të ashpër politike, ja plani i kryeministrit hungarez për të shkatërruar karrierën e Von der Leyen dhe Melonit

Faqe 14



politikë

Avokat Beqiri: Azem Hajdarin e vrau Sali Berisha, pasi e nxori atje në pritë

Shkëlzen Berisha dhe Argita kanë bërë trafik armësh me Mubarakun, Gadafin e Ben Alinë, ja pse SPAK po bllokoi arrestimin e Ilir Metës, Idajet Beqiri zbardh të dhënat tronditëse nga dosja me 140 faqe në tryezën e prokurorëve

Avokat i njohur, Idajet Beqiri ka komentuar situatën politike në vend. Gjatë një interviste për gazetën "SOT", zoti Beqiri akuzon fëmijët e ish-kryeministrit Sali Berisha, Shkëlzenin dhe Argitën se kanë bërë trafik armësh me Mubarakun, Gadafin e Ben Alinë. Po ashtu, avokati tregon se pse SPAK po bllokoi arrestimin e Ilir Metës, ndërkohë që zbardh të dhënat tronditëse nga dosja me 140 faqe që ndodhet në tryezën e prokurorëve specialë.



Gërdecin, për 21 Janarin, për privatizimet kriminale që janë bërë në këtë vend që është pakësuar pasuria.

-Avokat mos ndoshta provat janë të pamjaftueshme për të ngarkuar me përgjegjësi?

Provat janë në dritë të diellit dhe me kaq shumë prova sa ka, në të gjithë historinë 30-vjeçare të vendit tonë, ne me të 100-ën e këtyre provave, i kemi pas hekurave sot, i kemi madje dhe në burgim të përjetshëm. Kemi në burg të përjetshëm Jaho Mulosmanin pa provë fare në burgim të përjetshëm, në një kohë që nuk ka gisht në vrasjen e Azem Hajdarit. Ne kemi në burg 21 vjet tani e Gjykata e Lartë nuk pati guximin të prekte vendimin e Izet Haxhisë që nuk ka lidhje fare në vrasjen e Azem Hajdarit. Azem Hajdarin e vrau Sali Berisha, pasi e nxori atje në pritë, ai e organizoi komplet planin ndaj ardhja e Azem Hajdarit nga Fieri që e shpejtuan të dilte aty, e deri në pritën që iu bë. I kemi dënuar dhe i kemi në burg këto njerëz, po me kaq shumë prova për aferat e rënda korruptive, për vjedhjet e grabitjet e vrasjet që kanë bërë. Edhe SPAK nuk paska prova. Provat i ka por SPAK nuk e di se çfarë loje po bën dhe në lojën që po bën po dëmton veten e vetë, interesat kombëtare shqiptare, po e bën një popull shqiptar të flasë me veten sepse nëse filluan të vinin në Shqipëri shqiptarët që vetëm donin ta braktisin këtë vend e filluan të vitin sa u çua në arrest shtëpie Sali Berisha dhe sa morën vesh që do arrestohej dhe Ilir Meta, tani kanë filluar sërish të ikin pasi nuk kanë besim. Mungesa e besimit dhe ç'kurajimi i një populli kur ti nuk lufton krimin por i zvarrit proceset dhe mendon se ti qenke i zoti se do të bësh politikën, sot ky e nesër ai, me planifikim. Krimi është krim dhe nuk është planifikim, kush e bën duhet të shkojë në bankën e të akuzuarve. SPAK në këtë drejtim po i humbet pikë vetes dhe nga njeriu i vitit në 2023, po kthehet në të kundërtën në 2024-ën.

-Ndërkohë të kthehemi pas tek një çështje që shkaktoi debat. Çfarë përshlytjes iu la reportazhi i RAI3? Kemi të bëjmë me një investigim të mirfilltë, a ishte thelluar siç duhet gazetari? Kishte tendencë në atë material?

Ndoqa me shumë vëmendje reportazhin, pyetjet që bënte gazetari, e në mënyrën si insistonte në pyetjet që bënte dhe me të drejtë ai i mori të gjitha përgjigjet. Pyetje të padrejtë nuk ka, por problemi është te insistimi i pyetjeve që ai bën, asaj që vetë pyet dhe vetë do të përgjigjesh. Në këtë aspekt kuptova se kishim të bënim me një gazetar manipuluar po dhe i manipuluar. Manipulator sepse insistonte edhe kur e kishte gabim edhe atje kur nuk kishte fakte, por kishte grumbulluar mjaft thashetheme nga burime të pabesueshme. Nga burime me të cilat nuk mund të shkosh deri në akte jashtëzakonisht të rënda për një popull, për një vend e për një mënyrë qeverisje me atë që ndodhi me RAI3. Kjo nxjerr dhe disa mësim për vetë ne se mbase ai gazetar atë mision kishte që duke nxjerr marrëveshjen e kryeministrit tonë me Melonin, për ta nxjerrë atë të pavlefshme, për ta nxjerrë atë, të rëndë dhe të dëmshme për Shqipërinë posaçërisht por edhe për Italinë, ai arriti që të anatemojë një vend, një popull dhe një shtet me ato që i veshi. Për ta bërë të besueshëm, konkluzionet që

nxori na bëri në sikur jemi një narko-shtet që nuk ka asnjë gjë të vërtetë në këtë mes. Dhe nuk është problemi se nuk ka krime e kriminalitet në Shqipëri si në Itali e të gjitha vendet e botës, por problemi është se manipulimi arrin deri në nivelin sa të bësh të bardhën të zezë. Dhe sa të vrasësh njerëzit e tu ndonjëherë dhe me duart tona sepse ato i afrojnë informacione të tilla dhe që i paguajnë për fatin e keq gazetar dhe politikanë të tillë që lobojnë.

-Mendoni se gazetari është i paguar?

Të tëra janë bashkë, e para atë pagesën më të madhe ia ka bërë ajo forcë politike e cila është kundër Melonit në Itali. Ajo forcë politike e ka joshur gazetarin pasi ka dashur ta zvogëlojë atë marrëveshje e ta bëjë atë të pavlerë, të dëmshme, gjoja për Shqipërinë dhe Italinë dhe ato janë paguesit e parë. Pastaj, paguesit e dytë janë këto brenda nesh e cila është politika e pistë shqiptare dhe këto portale që janë kthyer në armë të rrezikshme vrastare në emër të fjalës së lirë, për ta vrarë demokracinë, për ta vrarë biznesin shqiptar, për t'i vrarë njerëzit e ndershëm të këtij vendi, ato njerëz që kallëzojnë, që deponojnë, që deklarojnë krimet e ndryshme që kanë ndodhur në këtë vend

e sulmohen në mënyrë barbare me mjetet shpifëse nga më të ulëtat. Unë e njoh jashtëzakonisht mirë atë këmbënguljen e madhe të gazetarit italian lidhur me aferën gjoja korruptive që po bëhet me kazinotë e me lojërat e fatit, duke përmendur një biznesmen shqiptar dhe që këmbëngulte ai dhe e lidhte me mafien në Meksikë, Luftar Hysën. Në një kohë që ai gazetar nuk kishte nga ta nxirrte atë lajm por ka dalë nga portalet e Shqipërisë e mori informacionin dhe ato ishin të parët që në formën e gjobë vënies, i vendosën gjobë Luftar Hysës dhe donin ta mpleksin e madje blenë edhe shkrim në Meksikë, e blenë shkrimin shtrenjtë, këto horrat e Shqipërisë për të thënë që ai është i lidhur me organizatën më të tmerrshme të trafikut të drogës atje. Në një kohë kemi të bëjmë me një person të thjeshtë i cili iku nga halli në 97'-ën pasi u bë masakra e Cërrikut, inxhinier i zoti dhe u bashku me të vëllanë e tij në Afrikën e Jugut. Atje la fëmijët jetim në Belsh të Elbasanit dhe arriti të bëhej atje për 2 vite e ca një mjeshtër, për lojërat e fatit në Afrikën e Jugut. Dhe ato pak para që vendosi atje, gjeti terren në Perru dhe atje mori disa pika bastesh të lojërave të fatit dhe filloi të bëhej i pasur. U bë mjeshtër në këtë punë dhe 9 biznese të tilla ka hapur në

Meksikë. Absolutisht asnjë lloj lidhje nuk ka me trafikantët. Punë e

ndershme, lek i pastër. Dhe këtë lek të pastër që bëri atje në Meksikë, erdhi që ta sillte dhe investonte në Shqipëri, u lidh me një biznesmen, që nga çdo pikëpamje dhe më erdhi jashtëzakonisht mirë dhe e përshëndes kryeministrin që e njihte shumë mirë se çfarë pasqyronte ai biznesi i Marina Bay në Vlorë. Burrë dhe grua, të

dy inxhinier të zot. Me një makinë ai, nga inxhinier, pronari i saj Besnik Lulaj, me një makinë të vjetër të parkut, merrej me transport të lloj-lloj, deri në 90-92-shin, derisa bëri pak lekë e ndërtoi një apartament e pastaj po ndërtonte të dytin e të tretin e të tjera me radhë. E futi të gjithë familjen, të 7 anëtarët e familjes që ka me djem e me vajzë e të gjithë të arsimuar në Angli e me diploma të shkëlqyera. I ka futur në biznes dhe ka bërë një biznes të pastër që nuk ka lidhje me krimin dhe drogën. Shikoni sa të pastër janë e ne ua servirim të huajve dhe atyre që duan të zezën e Shqipërisë, e konsiderohet sikur këto të pastrit po merren me trafik, për të fshehur trafiqet e vërteta të tyre, krimet e vetes së tyre. Dhe këto i bëjnë disa persona e biznesmenë të pistë që duan të fitojnë disa tendera në rrugë korruptive e të pandershme dhe pastaj i nxjerrin bojën vendit të tyre. ➔

“Çfarë po bën SPAK, pse nuk po i çon këto në gjyq, pse nuk po formëson, dosjet duhet t'i dërgojë në gjyq, pse nuk po çon në gjyq dhe nuk po merr masat e sigurimit për vrasjet e vëllezërve Haklaj, kur e ka të qartë situatën dhe kur i mori të gjitha dëshmitë, tëra provat i ka dhe aq më shumë që ka aty edhe dy dosje që ka krijuar vetë Dumani në Tropojë, vrasja e Haklajve”

Si zhvateshin paratë me projektet e BE dhe si fshihej pasuria

Muaj paniku për Ilir Beqajn, më 26 korrik vendoset fati i tij për një nga dosjet që po heton SPAK për abuzimet me koncesionet në shëndetësi, ja aferat e tjera të ish-ministrit që pritet t'i hanë "kokën", nga pastrimi parave, te zhvatja e parave të projekteve të BE, deri te "ortakët" që përdorte

Elmas BOGDANI

Korriku është muaji i panikut për ish-ministrin e Shëndetësisë Ilir Beqaj. Më 30 mars të këtij viti Prokuroria e Posaçme mbylli hetimet dhe dërgoi në gjykatë kërkesën e nisjes së gjyqit në themele për dosjen e Sterilizimit. Togat e zeza sipas përcaktimeve ligjore kishin 30 ditë kohë për tu shprehur nëse pranojnë kërkesën e SPAK, e kthejnë mbrapsht dosjen për plotësim hetimesh apo e pushojnë çështjen. Një vendimarrje që ndonëse kanë kaluar 4 muaj ende nuk është marrë. Ndërkohë që para një muaji, GJKKO pranoi kërkesën e ish-ministrit që akuzohet për shpërdorim detyre dhe ndaj tij është caktuar masa detyrim paraqitje, duke shtyrë seancën paraprakë për në datën 26 korrik, për të disatën herë. Tashmë nuk do të ketë më shtyrje, pasi afatet janë tejkaluar.

Hetimet ndaj Beqaj

Beqaj akuzohet për shpërdorim detyre të kryer në bashkëpunim dhe se nuk ka parandaluar konfliktin e interesit me biznesmenin Ilir Rrapaj dhe ish-zv.ministrin Klodian Rrjepaj. Ndërkohë kjo nuk është e vetmja çështje ndaj ish-ministrit. SPAK ka nisur një çështje të re, pasi dyshohet se si drejtues i ASPAC ka përfituar nga fondet e BE-së dhe



lidhje klienteliste me kompanitë farmaceutike. Mësohet gjithashtu se janë sekuestruar dokumente të rëndësishme në zyrë dhe janë bërë kontrole në banesën e tij nga agjentët specialë. Madje prokurorët i kanë shtrirë hetimet deri në Poloni për transferta të dyshimta parash. Madje jo vetëm kaq, përveç sterilizimit, emri i Beqaj del edhe te koncesionet e tjera në shëndetësi, të cilat po hetohen nga SPAK.

Kontrollet e BKH për Ilir Beqajn dhe njerëzit e tij

Në fund të vitit të kaluar, u miratua kontrolli banesë me vendim gjykatë për shtetasit Ilir Beqaj, Ermal Kurtulaj, Sabian Kurtulaj, Gazmend Prenga dhe Arben Dani. Po për këta shtetas është miratuar edhe kontrolli i automjeteve të tyre. Lapsi raportoi pak muaj më parë se personi kyç që dyshohet se ka kryer korrupsion pasiv dhe aktiv

për llogari të Ilir Beqaj, është shtetasi Ermal Kurtulaj, me detyrë Koordinator i projektit EUSAIR që menaxhohej nga Agjencia ku ish-ministri ishte drejtor. Kurtulaj rezultoi një njohje e hershme e Ilir Beqaj dhe bashkëpunëtor i afërt i tij. Madje edhe automjeti personal që përdor Ilir Beqaj, rezultoi në emër të Ermal Kurtulaj si një pasuri e dyshuar e fshehur e ish-ministrit të Shëndetësisë. Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike; Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike; Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimin, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim janë akuzat që dyshohet se kanë konsumuar të pandehurit.

Skema e përfitimit

SPAK thotë se shtetasi Ermal Kurtulaj ka kryer veprimtari të paligjshme nëpërmjet kërkimit dhe pranimit të lëshimit të faturave fiktive nga subjekte të ndryshme tregtare duke paguar shërbime që nuk kryhen prej tyre, duke vendosur vlera fiktive në faturime për qëllime të përfitimit material, si dhe është përfshirë në veprime korruptive për qëllime të përfitimit.

Sipas hetimeve paraprake të SPAK, dyshohet se kjo skemë është përdorur në të paktën 7 raste nga shtetasi Ermal Kurtulaj. Vlerat e këtyre faturave përllogaritet në qindra mijëra euro. Për dokumentimin e kësaj veprimtarie, SPAK ka kryer përgjime telefonike dhe ambientale të njerëzve të afërt të Beqaj. Në bisedat e përgjuara njerëzit e Beqes herë komunikojnë me kode dhe disa herë krejt të shpenguar.

Beqaj çonte para në ish-restorantin e tij

Në skemën korruptive figuron e përfshirë edhe kompania "Albanian Food and Hospitality Lab". Në këtë biznes ka qenë me herët aksioner Ilir Beqaj dhe bashkëshortja e tij Adriana Beqaj. Edhe pas largimit të tyre nga ky biznes de jure, SPAK ka provuar se çifti i bashkëshortëve vijonte të kishte kontrollin përmes personave të tjerë si Ermal Kurtulaj dhe Gazmend Prenga. Madje, për shumë dreka e darka me delega-

cione të huaja, agjencia që drejtonte Ilir Beqaj ka kryer disa pagesa në këtë restorant. Nga përgjimet e SPAK rezultoi se administratori de fakto i restorant "Gzona" ishte pikërisht Ermal Kurtulaj, vartësi i Ilir Beqaj në SASPAC. Mësohet se SPAK ka kapur Ilir Beqajn duke komunikuar me sekserin e tij Ermal Kurtulaj përmes telefonit të shtetasit, Arben Dani, i cili është shoferi i ish-ministrit.

BKH mësyn në SASPAC

Agjentët e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe Oficerët e Policisë Gjyqësore për rreth 12 orë kanë kontrolluar zyrat dhe kanë marrë qindra dokumente për procedura të ndryshme të SASPAC, kanë marrë në pyetje disa punonjës, si dhe kanë sekuestruar celularë e kompjutera të ndryshëm.

BKH mësyn në disa kompani

Gjykata ka lejuar kontrollet e zyrave dhe selive të kompanive: "Curri Group", "Delta Holding", "Farmed Antibiotics", "Delta Pharma", "Delta Med", "Gzona Restaurant" dhe Shoqata Good Health. Përmes këtij rrjeti kompanish dhe personave që përmenden në këtë dosje, dyshohet se ish-ministri i Shëndetësisë, Ilir Beqaj ka fshehur pasuri të tij dhe ka bërë korrupsion duke shpërdoruar detyrën. Mbetet për t'u parë se si do të zhvillohen hetimet më tej për këtë dosje dhe nëse do të ketë të arrestuar apo jo.

-Avokat ju e dini që momentalisht me Greqinë marrëdhëniet i kemi në pikën 0, e sidomos pas tubimit të kryeministrit Edi Rama në Athinë. Është shprehur dhe kryeministri grek që në jemi fqinj ndaj jemi të dënuar në një farë mënyre të jetojmë bashkë. Si i keni parë këto deklarata, pse gjithë ky mllef?

Për hir të së vërtetës, pavarësisht se dikush mund t'i konsiderojë marrëdhëniet tona 0, unë do të thoja marrëdhëniet sot Shqipëri-Greqi janë në majën më të lartë të marrëdhënies së tyre pasi hoqëm petkun e hipokrizisë, e hoqëm petkun e hipokrizisë e një mënyrë qeverisje servile e poshtëruese, të nënshtruar nga qarqe të ndryshme greke deri në atë shkallë sa na impononin që do të bëheshin në Greqi por nuk do të zësh me gojë kurrë problemin çam, do të bëhesh vizitë në Greqi apo do vij unë në Shqipëri për të bërë një vizitë, por në asnjë mënyrë nuk do të nënshtrorsh problemin e ligjit të luftës. Një hipokrizi maksimale në një kohë që e vërteta duhet parë në sy dhe për herë të parë e historinë e shtetit Shqiptar, një kryeministër me vizionin e tij, me guximin

e tij, një diplomat i madh pasi në ato nivele e ka çuar Shqipërinë, në ato lartësi ku tregon se nuk qenka numri i popullsisë apo vendi ku sado i vogël të jesh por kur ke të vërteta të mëdha me vete dhe kur di të bësh politikë e diplomaci, bëhesh i rëndësishëm sado vend i vogël të jesh. Dhe ne u bëmë të rëndësishëm se Këshillin e Sigurimit dhe OSBEE-në e drejtuam, por dhe në mes të Athinës ua thamë të gjitha të vërtetat dhe i themi kjo është e vërteta. Tani hajde të ecim e jetojmë bashkë, të shkojmë në BE bashkë e jetojmë në harmoni bashkë.

-Por mesa duket Greqia nuk është dakord për këtë gjë?

Është tjetër punë, pasi Greqia tani nuk mundet të mbulojë diellin me shoshë, ata e dinë të vërtetën dhe nuk e mbulojnë dot më. Po i bëjnë të gjitha përpjekjet që ta shtynin e ta shtynin qoftë problemin e ligjit të luftës që lidhet me pasuritë e shqiptareve në Greqi e qoftë edhe problemin e zgjidhjes së çështjes Çame, por në fund të fundit, ata vetë janë të përgjegjshëm se shikojnë të gjitha zonat ku janë shqiptarët dhe ku kanë jetuar dhe ku kanë pasuritë e tyre çamët.

-Kjo klimë ku do na çojë pasi Fredi Beleri pritet që të zgjidhet eurodeputet ku sondazhet e nxjerrin fitues e madje në tre vendet e para. Mitsotaqis është shprehur se kemi dy kryetar shqiptar në Parlamentin Europian dhe e luan këtë kartë si triumf të madh?

E para, Beleri nuk e quan veten shqiptar, kështu që në këtë pikë Mitsotaqis gënjen veten dhe faktori ndërkombëtar e Parlamentin Europian që do rinovohet e do të ketë përbërjen e vetë të re. Beleri asnjëherë nuk e ka pranuar që është shqiptar. Në të vërtetë ai është shqiptar por nuk e ka pranuar pasi interesat e detyruan të bëheshin të tillë e madje interesat e bënë atë dhe një ndër kriminelët më të mëdhenj, pasi u bë vrasës pasi bëri akt terrorist në Peshkëpi dhe vrau atje.

-Marrëdhëniet shqiptaro-greke deri në cilën pikë do të shkojnë tensionet, deri ku do të shkojë hakmarrja greke?

Greqia nuk ka asnjë fuqi të bëjë absolutisht asnjë gjë, sepse Shqipëria negociatat i ka hapur me BE, të gjitha objektivat e vëna, të gjitha detyrimet që ajo ka ndaj BE,

po i plotëson e shumicën e ka plotësuar në mënyrë perfekte ku ka marrë nota shumë të mira nga BE, samitet që janë organizuar në Tiranë, e kanë treguar fare mirë një gjë të tillë. Greqia forcë për të penguar nuk ka, e dëgjuam Gjermaninë, dëgjuam Francën, etje dhe ajo VETO do të zhvlerësohet përfundimisht tashmë.

-Sa i përket shqiptarëve që punojnë dhe jetojnë atje?

Shqiptarët që jetojnë në Greqi shumica janë kthyer në grek e punojnë aty e kanë bërë një emër të shkëlqyer, atë punë që e bëjnë shqiptarët atje nuk e bëjnë dot grekët dhe pa shqiptarët, ajo Greqi sot do të vazhdonte vetëm shitjen e ishujve me borxhin që i ka krijuar Europës dhe faktori shqiptar ua ka zvogëluar dhe ua a zbutur këtë krizë nga më të rëndat sepse janë rreth 600 mijë shqiptarë dhe kanë përballuar punë të tilla të jashtëzakonshme. Ata jetojnë me popullin grek në harmoni, e në mirëkuptim dhe nuk i ndajnë farë këto furtuna në gotë, ku politika ditën bën sikur qan e natën puthen e kështu ec kjo punë.

Intervistoi: Rigels SELIMAN

aktualitet

Lulzim Basha: Jemi e djathta e çliruar nga Katovica, kemi filluar bisedimet për koalicion me partitë e tjera, përballë kemi aleancën kundër SPAK

Kreu i Demokratëve Euroatlantik, Lulzim Basha, deklaroi dje në një intervistë televizive se ka nisur bisedimet me partitë që bashkohen rreth propozimeve për ndryshime zgjedhore dhe në mbështetje të qartë për SPAK. Sipas Bashës, Rama dhe Berisha janë në një pazar për të penguar listat e hapura dhe votën e diasporës me anë të sabotimit të reformës zgjedhore, duke i cilësuar si hallexhinjtë e SPAK të cilin duan ta paralizojnë. Basha theksoi se hallin më të madh përballë SPAK e ka kryeministri Rama, i cili sipas tij, i frikësohet ndjekjes penale

për shkak të aferave të shumta korruptive. “është e qartë që pas pazarit për amnistinë, pas shkatërrimit të komisionit për Reformën Zgjedhore, pas pazarit për vulën, janë dy pazare të tjera që priten të vijnë njëri pas tjetrit. Pazarit i parë është t’i rimbyllin listat që të vendosin Sali Berisha dhe Edi Rama se kush do të jetë kandidat për deputet, që shpjegon dhe marrëzinë kolektive të hipokritëve që janë tubuar poshtë ballkonit. Dhe pakti tjetër është për hallin më të madh që kanë bashkërisht, madje do të thoja që halli në rastin e Ramës, ndonëse

akoma i pushpërfaqur është disa herë më i madh që është SPAK-u dhe ndjekja penale për afere të shumta korruptive që janë bërë skandale me jehonë botërore, që nga ato të inceneratorëve të shëndetësisë dhe padiskutim skandali i korruptimit të kreut të kundërinteligjencës amerikane McGonigal. Pra në këtë kuptim këta janë hallexhinjtë e SPAK-ut, prandaj i bashkon nevoja, domosdoshmëria jetike për të paralizuar SPAK-un. Ndaj dhe sot nga studioja juaj dua të jap këtë paralajmërim publik, po, dy stacionet e ardhshme janë: të rimbyllin listat zg-

jedhore, pra most të kenë lista të hapura, sot janë të hapura për shkak të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Njëkohësisht të mos lejojnë që shqiptarët jashtë Shqipërisë të votojnë përveçse me ndonjë kanal të ngushtë dhe të pisët dhe të cekët që i intereson qeverisë për të mbledhur disa militantë. Dhe natyrisht me ato truket e veta, t’ia lënë përgjegjësinë për këtë rithemelimin duke u thënë ja ku janë listat e mbyllura, nuk duan votimin elektronik. Pra, gjuha është e qartë, është gjuha e dikujt që ka kapur dikë tjetër dhe e mban fortë prej bluzeje. E dyta është

SPAK-u. Kemi filluar tratativat për koalicion me partitë e tjera të vogla. Dua t’i them çdokujt që nuk ka qenë pjesë e këtyre bisedimeve që nuk e kemi strukturuar. Do strukturohet shumë shpejt. Aktualisht ka formën e një koalicioni për kodin zgjedhor, por do të shtrihet padiskutim shumë shpejt në një koalicion substantiv në të cilat do të merren parasysh interesat më themelore të vendit, por pa humbur identitetin tonë si e djathta e vërtetë dhe e munguar e Shqipërisë në këto 34 vite. E djathta e çliruar nga Katovica”, deklaroi dje Basha.

Vrasja e Pjerin Xhuvanit, Apeli ndryshon vendimin për Arbër Papekaj, i ul 15 vite burg, i ndryshon dhe akuzën, të pafajshëm edhe efektivët

Arbër Papekaj dënohet me 7 vite për vrasjen Pjerin Xhuvani, a do ta hetojë Prokuroria Gazment Bardhin si drejtues i strukturës për Mbrojtjen e Votës nga PD, ja roli i “ushtarit” të Berishës në ekzekutimin që tronditi Elbasanin

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dënoi dje me 7 vite burg Arbër Papekaj, ish-efektiv i RENE-s i arrestuar për vrasjen e biznesmenit Pjerin Xhuvani, 4 ditë para zgjedhjeve të 25 prillit 2021 në qytetin e Elbasanit. Me vendimin e djeshëm trupa e gjyqese e përbërë nga Fadri Islamaj, Enida Petri dhe Marsela Pepi ndryshoi vendimin e Gjykatës së Elbasanit, e cila më 22 korrik 2023, e dënoi me 22 vite burg, duke u ulur 15 vite nga dënimi. Gjykata e Apelit ndryshoi akuzën nga ‘vrasje në rrethana cilësuese’ në ‘vrasje në kushtet e tronditjes psikike’. Po kështu Apeli ka dhënë pafajësi për 6 efektivët e Shqiponjave Dedion Duraku, Pëllumb Biçaku, Erion Balla, Erion Meçja, Donald Dedja dhe Besmir Kadiu. Për ta gjykata e Elbasanit kishte dhënë dënimin me 16 muaj shërbim prove. Të pafajshëm janë shpallur edhe dy ish-zëvendësudrejtorët e Policisë së Elbasanit, Albert Nushi dhe Nikollaq Palla për të cilët Gjykata e Elbasanit kishte dhënë nga 1 vit shërbim prove për secilin. Por ky vendim është një kambanë alarmi për deputetin Gazment Bardhi. Ky i fundit në vitin 2021 ishte drejtues i Strukturës së Mbrojtjes së Votës së ngritur nga PD. Ndërkohë Arbër Papekaj përveçse ishte pjesë e saj, ishte dhe shoqëruesi i kreut të listës së Partisë Demokratike në Qarkun e Elbasanit, Gazment Bardhi. Kështu që nëse Prokuroria heton si duhet këtë ngjarje, “ushtari” i Sali Berishës, Gazment Bardhi rrezikon të merret në hetim, pasi ishte drejtues i strukturës që shkaktoi edhe vrasjen në Elbasan në vitin 2021.

Vendimi

“Në përfundim të gjykimit, sot më datë 01.07.2024, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, e përbërë nga trupa gjyqese me Relatore Gjyqtare znj. Marsela Pepi dhe anëtare znj. Edlira Petri dhe z. Fatri Islamaj, vendosi:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 347, datë 12.07.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.



2. Deklarimin fajtor të të pandehurit Arbër Papekaj për veprën penale “Vrasje e kryer në kushtet e tronditjes se forte psikike”, të parashikuar nga neni 82 i Kodit Penal, në dëm të viktimës nga vepra penale P. Xh dhe dënimin e tij me 7 (shtatë) vjet burgim.

3. Deklarimin e pafajshëm të të pandehurve, Albert Nushi dhe Nikollaq Palla, Dedion Duraku, Pëllumb Biçaku, Erion Balla, Erion Meçja, Donald Dedja dhe Besmir Kadiu për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Deklarata e rreme para oficerit të policisë gjyqësore”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 248 dhe 305/b të Kodit Penal.

4. Prishjen e vendimit nr. 347, datë 12.07.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe pushimin e çështjes vetem për të pandehurin Erion Balla, për shkak përjashtimi nga ndjekja penale në zbatim të ligjit nr. 33/2024 “Për dhënie amnistie” thuhet në vendimin e gjykatës.

Si ndodhi vrasja e Pjerin Xhuvanit?

Kujtojmë se ngjarja e bujshme në Elbasan ndodhi 4 ditë përpara zgjedhjeve parlamentare të prillit 2021, ku u vra Pjerin Xhuvani, një eksponent i fuqishëm lokal i lidhur me Partinë Socialiste, i cili ishte i përfshirë direkt në fushatën e PS në këtë qytet. Pjerin Xhuvani mbeti i vrarë në Elbasan, pasi u qëllua me armë nga Arbër Papekaj, shoqëruesi i kreut të listës

së Partisë Demokratike, Gazment Bardhi. Nga ngjarja e 21 prillit, të plagosur mbetën edhe katër persona të tjerë, Emiljan Prenga, Pavlo Vuk-sani, Elton Bodinaku dhe Xhensila Sota (punonjëse e policisë). Papekaj pranoi krimin dhe u vetëdorëzua në Repartin e Forcave RENE në Tiranë duke thënë se qëlloi për vetëmbrojtje pasi u qëllua më parë nga persona që sipas tij po blinin vota. Ngjarja zbuloi edhe skandalin e PD-së për ngritjen e një grupi të armatosur, të vetëshpallur Struktura për Mbrojtjen e Votës, ku një pjesë e mirë e anëtarëve të së cilës rezultuan persona të njohur edhe për strukturat ligjzbatuese në vend. Përplasja me armë ndodhi për shkak të zgjedhjeve. Struktura e Mbrojtjes së votës e ngritur nga PD pretendonte se makina e shtabit të PS-së është kapur duke shpërndarë para në këmbim të votës. Pas konstatimit të makinës, është thirrur edhe policia. Në vendin e ngjarjes mbërriti më pas nëndrejtori i Policisë së Elbasanit, Albert Nushi dhe disa efektivë të Shqiponjave. Pas mbërritjes së policisë, në vendngjarje erdhi edhe një automjet me simpatizantë të PS-së. Në këtë moment ka nisur edhe shkëmbimi i zjarrit mes palëve. Pak minuta pas ngjarjes u vetëdorëzua në polici ish-efaktivi i RENE-s Arbër Papekaj, i cili dyshohet se ka qëlluar me armë ndaj Xhuvanit gjatë shkëmbimit të zjarrit. Ky i fundit ka thënë vazhdimisht se ka qëlluar për vetëmbrojtje.

U arrestua me urdhër të SPAK, GJKKO lë në burg Astrit Avdylajn, ja kush është i forti i bandës së Shijakut që akuzohet se është përfshirë në disa krime

Gjykata e Posaçme (GJKKO) ka lënë në fuqi masën e sigurisë “arrest me burg” për kreun e grupit të Shijakut, Astrit Avdylaj. Gjatë seancës së djeshme, Avdylaj nuk ka dhënë asnjë deklaram. Astrit Avdylaj u arrestua me 29 qershor në banesën e tij. Më herët u publikuan edhe pamje nga vënia e tij në pranga. Gjatë arrestimit, 50-vjeçarit i është sekuestruar edhe një armë zjarri tip pistoletë. Avdylaj u shpall në kërkim nga SPAK, në kuadër të operacionit “Revanshi”, ku u goditën disa grupe kriminale dhe u arrestuan dhjetëra eksponentë të krimit. Dyshohet se ai ka ndihmuar Ervis Martinajn dhe ish-deputetin socialist Arben Ndokën, duke i siguruar kushtet për vrasjen e Durim Bamit. Komunikimet në aplikacionin “Sky” treguan se si Astrit Avdylaj bisedonte me Ndokën dhe ofrohet ta ndihmojë atë në planin për eliminimin fizik të Durim Bamit. Avdylaj i dërgon nipin e tij Aldo Avdylajn dhe Arben Mërkurin, Ndokës për të realizuar qëllimin. Por kush është Astrit Avdylaj? Astrit Avdylaj, njihet si kreu i bandës së Shijakut dhe ndaj tij ka pasur akuza droge, vrasje, prostitucion, por edhe për lidhje të forta politike, së bashku me vëllanë e tij Altin Avdylajn. Operacioni masiv i tetorit 2018 “Vol-Vo 4” arrestoi 22 persona. Sipas Gjykatës së Krimeve të Rënda, rezultoi se ekzistonin lidhje mes disa organizatave kriminale më në zë në vend, të cilët trafikonin kokainë dhe heroinë nga Amerika Latine drejt vendeve të Bashkimit Evropian, të drejtuara nga Shijaku e Maminasi, ndërsa për kanabisin ishin të angazhuara dhe organizatat e tjera kriminale. Banda e Avdylajve në Shijak bashkëpunonte me atë të Bajrave në Shkodër dhe Ndokajve në Lezhë. Në krye të tyre ishte i njohuri Astrit Avdylaj ose ndryshe

Astrit Balliu, që merrej me trafikun e drogës nga Shqipëria drejt Italisë. Hetimet për këtë çështje janë nisur që në dhjetor të vitit 2016. Rrugëtimi kriminal i Avdylajve ka nisur që në vitet 90, ku në 1996-ën është vrarë me armë zjarri Dritan Avdyli, kushëriri i parë i Astrit Avdylit. Astrit Avdylaj, djali i xhaxhit të Dritanit, i dënuar më parë për prostitucion në Itali ka marrë hak duke vrarë në qendër të Shijakut personin që nxori në pritë Dritanin. Hakmarrja nuk u ndal me kaq, pasi vëllai i Astritit, Shkëlqimi vrau në Tiranë, Durim Kusin. Edhe familjarë të tjerë, si Jasmin Avdylaj apo Flamur Avdylaj janë të lidhur me botën e krimit. I dënuar me 16 vjet burg për një vrasje të ndodhur në vitin 1997, Avdylaj ndërmoi një betejë ligjore 10-vjeçare për lirim të parakohshëm nga burgu i Shënkollit-dhe në fund e fitoi. Dokumentet gjyqësore tregojnë se Astrit Avdylaj u lirua pas 13 vitesh burg, pasi siguroi më parë një raport mjekësor që e diagnostikonte atë me “depression endogjen me tentativa vetëvrasëse”. Ai doli nga burgu më 2 mars 2016, pasi Gjykata e Lartë urdhëroi lirimin e tij me argumentin se “qëndrimi në burg i rrezikonte jetën”. Vetëm pak kohë pas lirimit nga burgu, Avdylaj u vendos nën hetim për përfshirje në trafikun e drogërave të forta. Për dy vjet e gjysëm, Prokuroria e Krimeve të Rënda kreu me qindra orë përgjime dhe ndërroi tre grupe prokurorësh, derisa në tetor 2018 ngriti akuza për 44 persona të akuzuar për trafik ndërkombëtar droge, korrupsion, ushtrim ndikimi të paligjshëm apo falsifikime masive me pronat. Astrit Avdylaj u lirua nga qelia e parburgimit dy vite pas arrestimit të bujshëm, në korrik 2021 dhe përfundoi në “arrest në shtëpi”.

Lulzim Basha: Meritojmë të jemi alternativa ndaj një qeverie që Shqipërinë e ka shpopulluar, Berisha po sillet si Faraoni që po kyç ushtrinë në piramidë

Kreu i Demokratëve Euroatlantik, Lulzim Basha, në intervistën televizive është shprehur dje se sot Partia Demokratike që vazhdon të mbetet e zhveshur nga çdo sens misioni, përveç misionit që ka ndaj liderit të vet historik i cili për fat të keq demonstron një vullnet prej Faraoni. Ai tha se pas vendimit të 11 qershorit, hipokrizia është tipari dallues tek grupi i tij, pasi thonë gjëra që as vet nuk i besojnë dhe se entuziazmi nuk ekziston. "Kemi një Parti Demokratike që është bërë me letra në 11 qershor, por që

vazhdon të mbetet e zhveshur nga çdo sens misioni, përveç misionit që ka ndaj liderit të vet historik i cili për fat të keq, meqë jemi akoma tek Kadareja, tek vazhdimësia, tek jehona e veprës së tij, po demonstron një vullnet prej Faraoni për ta kyçur ushtrinë në piramidë. Dhe kjo sigurisht është e patolerueshme, është diçka që edhe diktatura ndonëse mund ta ketë ëndërruar, mund ta ketë dëshiruar nuk arriti dot ta bënte as me Partinë e Punës së Shqipërisë, e jo më ata që PD i ka bashkuar si një ëndërr për Shqipërinë si gjithë

Europa, ta pranojnë të kthehet në një tempull idhujtarie të rreme. Kriza që kjo shkaktonte, dallohet qartë. Ata që ndjekin Faraonin në piramidë, tipar kryesor kanë depersonalizimin. Ata thonë gjëra që vet nuk i besojnë. Hipokrizia është tipari dallues dhe kjo natyrisht shoqëron edhe javët që kanë rrjedhur që prej 11 qershorit ku nuk ka as entuziazëm, as gëzim dhe asnjë moment të ri bashkimi apo ribashkimi energjish për misionin që duhet të ketë normalisht partia më e madhe në opozitë, që është të bëjë gjithçka për të larguar një

qeverisje tashmë të vet të 12 dhe zullume rekord në këto 34 vite", deklaroi ai. Më tej zoti Basha është shprehur se të cilët kemi një mision për të përmbushur nevojën e shqiptarëve për një alternativë politike. "Nga ana tjetër jemi ne, sigurisht të deprivuar në mënyrë të paligjshme dhe për këtë do të bëjmë rekurs jo vetëm për paligjshmërinë që prek dhe cënon drejtpërdrejtë Partinë Demokratike të Shqipërisë, por edhe për paligjshmërinë si një sëmundje në vazhdim të një sistemi drejtësie që është futur në repartin e emer-

gjencës, por akoma nuk ka dalë plotësisht e shëruar nga sëmundja 34 vjeçare e korrupsionit. Por veç nga kjo, ne kemi një sens misioni dhe është ky sens misioni që na ka bërë bashkë në kohë shumë të vështira. Që na ka bërë të dallojmë simpatinë personale, apo qoftë dhe bindjen personale nga kotësia e idhujtarisë dhe nga nevoja për t'iu dhënë shqiptarëve një alternativë politike. Sepse ne nuk kemi një klub tifozësh. Ne mëtojmë të jemi alternativa ndaj një qeverie që Shqipërinë e ka shpopulluar", nënvizoi dje Basha.

"Unë kafshë të tillë nuk kam parë e nuk honeps dot. Ka rënë sistemi në mjekësi totalisht"

Romeo Kara zbulon se çfarë do të ndodhë me përplasjen e Olsi Ramës dhe Gazment Bardhit në dyert e Prokurorisë së Posaçme dhe tregon detaje nga dosja që pritet të hapë SPAK ku dalin mjekë të përfshirë në vrasje, ja detajet e rënda që do të dalin nga skandali më i madh dhe më i pështirë që ka ndodhur këto 33 vite

Rigels SELIMAN

Juristi i njohur, Romeo Kara ka komentuar situatën politike në vend, duke e ndalur theksin tek skandali i spitalit Onkologjik dhe përplasjet në distancë mes kreut të grupit parlamentar të Partisë Demokratike, Gazment Bardhi dhe vëllait të kryeministrit Edi Rama, Olsi Rama. Ky i fundit është paraqitur pak ditë më parë në SPAK. Zoti Olsi Rama tha se ishte për të marrë një përgjigje nga Prokuroria e Posaçme, ndërsa mohoi që të jetë i përfshirë në çështjen "Xibraka". Rama tha se nuk ka asnjë lidhje me atë çështje. Por për këtë çështje ka folur edhe juristi Romeo Kara. Në një intervistë televizive në emisionin "Top Talk" në "Top Channel", zoti Kara zbulon se çfarë do të ndodhë me përplasjen e Olsi Ramës dhe Gazment Bardhit në dyert e Prokurorisë së Posaçme, ndërkohë që tregon detaje nga dosja që pritet të hapë SPAK ku dalin mjekë të përfshirë në vrasje.

-Zoti Kara dua t'ju marr një koment në lidhje me përplasjen që vijon mes Olsi Ramës dhe Gazmend Bardhit, një çështje tashmë në dyert e Prokurorisë së Posaçme (SPAK)?

Për mua është procedurë për çdo person që bën kallëzim në Prokurori të thërritet për deklarime në mbështetje të kallëzimit. Besoj, dhe pse nuk u kuptua mirë nga prononcimi i Olsi Ramës që do të ketë qenë kjo procedurë, për këtë arsye do ta ketë thirrur SPAK-u. Unë nuk shoh procedurë tjetër. Nëse kjo është në lidhje me kallëzimin që ka bërë vetë Olsi Rama. Pjesa tjetër është retorikë politike, SPAK-u i ka të dyja dhe akuzën e Bardhit dhe kallëzimin e Olsi Ramës. Besoj duhet ta lëmë tani prokurorinë e po bën shumë mirë që po



i sheh të dyja. Të hapim, të shohim dhe pastaj të komentojmë më tej.

-Deri tani duket se po i jepet një ngjyrim politik?

Ngjyrim politik, gjithmonë ka se është një person i cili është deputet, kryetar i një grupi parlamentar që po e bën këtë akuzë, nuk mund të shmanget nga manteli dhe retorika e tij politike. Është interesante se Olsi Rama ka kërkuar e ka bërë një kallëzim për shpifje, SPAK-u tani ka mundësinë ta verifikojë ngjarjen në të dyja anët. Unë jam gjendur në të njëjtin pozicion me Berishën, nuk më ka kallëzuar për gjëra e unë e kam akuzuar hapur për korrupsion lidhur me privatizimin e CEZ-it. Është sot dosja në Gjykatën e Lartë e dërguar nga unë. E ftoja që të më akuzonte për shpifje lidhur me akuzat e mia, por nuk e bëri e ta hante atë karrem. Se dhe aty, lidhur me akuzat për shpifje unë do të arrija të provoja akuzat e mia për korrupsion. Pra kjo është sfidë që e ka marrë edhe Olsi Rama vetë. Nëse do të jetë i zoti Bardhi e të provoj akuzat e tij, të shkojë t'i provojë tani në SPAK, ka dy mundësi procedurale për t'i provuar.

-Në rast të mos aprovimit të akuzave dhe deklaratave që ka bërë ndaj Ramës, rrezikon të akuzohet për shpifje?

Banka e provës i bie atij që ka bërë shpifje. Ai do të jetë i detyruar të provojë akuzat e tij, meqë ka bërë dhe kallëzim, ku nuk bëhet pa u mbështetur në fakte dhe në prova, përtej dyshimit të arsyeshëm, atëherë ato që ka thënë në kallëzim do t'i thotë në SPAK dhe ka mundësinë tani të bindi Gjykatën Kushtetuese. Këtu shtrohet çështja ku dy persona do të përballen, njëri në akuzë për trafik e tjetri me akuzën për shpifje.

-Avokat si i keni parë zhvillimet në lidhje me skandalin e Onkologjikut, skemë skandali e zbuluar nga Prokuroria e Tiranës por edhe mënyrën si është proceduar me masat e sigurisë?

E them me bindje të plotë, skandali më i madh dhe më i pështirë që ka ndodhur këto 33 vite. Të tillë mjekë janë jo vetëm turpi i mjekësisë por edhe i racës njerëzore, unë nuk kisha hasur, pavarësisht se ne e dimë që ka gëluar ky lloj korrupsioni. Por deri në këtë nivel që me gjak ftohtë të shkosh me pushime në Maldive, e të trashësh si ky damllaja me paratë e një njeriu që po vdes që e di ai si i ka marrë ato para me kredi apo ka shitur pronë e gjë. Unë kafshë të tillë nuk kam parë e nuk honeps dot. Ka rënë sistemi në mjekësi totalisht. Të bëhet shembull, pasi shoh se i kanë bërë veprimet me vetëdije dhe kanë pasojë vdekjen e pacientëve të tyre. Këta mjekë duhen gjykuar në SPAK, pasi kanë bërë vrasje, jo për mjekim të pakujdesshëm por kanë vrarë njerëzit duke shpërdoruar detyrën e tyre e madje kanë bërë dhe korrupsion. Këta, kanë organizuar deri te farmacitë, pra është krim i organizuar. Të dyja këto i ka SPAK-u kompetencë. Jam i bindur se këtë dosje do ta marr SPAK-u.

Berisha: Rama u përpoq të mbulojë krimet kundër njerëzimit që ka shkaktuar ai personalisht me sistemin e falimentuar të shëndetësisë

Lideri i opozitës, Sali Berisha ka akuzuar drejtpërdrejtë kryeministrin Edi Rama si personi përgjegjës që ka shkaktuar krimet kundër njerëzimit në lidhje me skandalet në shëndetësi. "Rama u përpoq të mbulojë krimet kundër njerëzimit që ka shkaktuar ai personalisht me sistemin e falimentuar të shëndetësisë", theksoi Berisha gjatë fjalës së tij në protestën maratonë të "Ruga e Shpresës". "Një përsëritje të përzemërt ju, një përsëritje të përzemërt oratorëve të kësaj platforme, që me fjalën e tyre u thonë shqiptarëve të vërtetat që fsheh me censurën regjimi i drogës, vjedhjes dhe krimin, regjimi i Edi Ramës. Të dashur miq, të dashur qytetarë dhe qytetare, sot kreu i narkoshtetit shkoi në një takim me elitën mjekësore të vendit. I damkosur para shqiptarëve për sistemin e shëndetësisë që ndërtoi, sistemin më korruptiv të planetit, ai para mjekëve, drejtuesve të klinikave, foli për krime kundër njerëzimit. Të dashur miq, kurrë ndonjëherë nuk kam qenë më dakord se sot me Edi Ramën kur foli për krime kundër njerëzimit. Dua ta kemi të qartë se ai është autori më i madh i krimeve kundër njerëzimit dhe i gjenocidit kundër shqiptarëve me krimin e kushteve për shpopullimin e tyre. Por meqenëse ai, krimet kundër njerëzimit me të drejtë i lidhi dhe me krimin ndaj një njeriu, të një mjeku apo personeli mjekësor, i them se në këtë aspekt ai u përpoq të mbulojë krimet e shëmtuara kundër njerëzimit që ka shkaktuar ai personalisht, ministrat e tij ndaj të sëmurve, ndaj shqiptarëve në sistemin e korruptuar dhe të falimentuar të shëndetësisë shqiptare. Është e vërtetë që një mjek, një infermier që pasurohet në dëm të jetës së një të sëmuri, kryen një krim të shëmtuar. Por ky krim është 600 herë më i madh kur drejtori i tij, ministra e tij lënë për tre vite pa mjekim radioterapeutik me brankoterapi 600 gra dhe vajza shqiptare që vuajnë nga sëmundje neoplazike. Dhe që i lënë për tre vite në mëshirë të vdekjes, në mëshirë të sëmundjes. Mos do të mbulosh ti me sulmin me një rast të veçantë, krimin makabër që kryen duke lënë pa mjekim për tre vite me radhë 600 të sëmura. Me mjekimin që mund të ndryshonte rrënjësisht prognozën dhe jetën e tyre.

aktualitet

Sali Berisha: 11 korriku është dita kundër krimeve të njerëzimit të kryera mbi shqiptarët nga Edi Rama

Kreu i PD, Sali Berisha në fjalën e tij përpara protestuesve është shprehur dje se 11 korriku është dita kundër krimeve kundër njerëzimit të kryera mbi shqiptarët nga Edi Rama. Berisha ka theksuar se 11 korriku është dita të luftojmë për qindra-mijëra njerëz që vdiqën në kthetrat e një mjekësie të pashpirt, të shndërruar nga Edi Rama, ministrat e tij në

një bursë vdekje. Shqiptarë, të cilët fatmirësisht jeni pa asnjë sëmundje dhe të shëndoshë, është koha e fundit të mendoni për të sëmurët e këtij vendi, se sot jeni të shëndoshë, por nesër mund të pësoni fatin e tjetrit. Nuk duhet kurrë të heshtësh, nuk duhet kurrë të pranosh këtë shkatërrim, këtë korrupsion, këtë pashpirtësi të Edi Ramës, Manastirliut, Beqës

dhe kësaj tjetres që ka marrë tani në ministri. O miq, kjo nuk është vetëm në shëndetësi, po kjo është në çdo fushë. A nuk është krim kundër njerëzimit që 18 përqind e fëmijëve të mos mund të ushqehen me një ose dy vakte në ditë? Uria është torturë, dhe ti torturon 18 përqind të fëmijëve në Shqipëri sepse vjedh, vjedh dhe vetëm vjedh me sojin tënd. A nuk janë këto motive

për një betejë për jetë dhe vdekje kundër këtij armiku? A mund të durohet më tej? Edhe njëherë miq, një president në Kenia u zgjodh duke u premtuar kenianëve se do u lehtësojë varfërinë dhe pas një viti u rriti taksat. Kenianët i vunë kufirin te thana. Vërtet u vranë, por triumfuan, por fituan, i dhanë shembull se si luftohet kundër atyre që të poshtërojnë,

kundër atyre që të mashtrojnë. Ndaj dhe 11 korriku po vjen, 11 korriku është dita kundër krimeve kundër njerëzimit të kryera mbi shqiptarët nga Edi Rama. 11 korriku është dita të luftojmë për qindra-mijëra njerëz që vdiqën në kthetrat e një mjekësie të pashpirt, të shndërruar nga Edi Rama, ministrat e tij në një bursë vdekje”, deklaroi dje Berisha.

Noka thotë se PD krahas organizimit të protestës së 11 korrikut, është angazhuar edhe në procesin e bashkimit të demokratëve

Sali Berisha po mbahet i burgosur pa asnjë provë, Flamur Noka sulmon SPAK dhe kërcënon me destabilitet

Vendi nuk do të ketë stabilitet nëse Qeveria nuk adreson krizën politike. Kështu ka deklaruar sekretari i Përgjithshëm i Partisë Demokratike, Flamur Noka, në një intervistë televizive ditën e djeshme. “Stabilitet Shqipëria pa zgjidhje politike nuk do të ketë. Ta harrojmë Edi Rama se mund të gëzojë karrigen e sulltanit të Surrelit pa i dhënë zgjidhje situatës politike në vend”, deklaroi ai. Noka tha se për stabilitetin politik, demokratët kanë dy kërkesa kryesore të cilat do t’i lancojnë në protestë e 11 korrikut, sikundër është lirimi i Kryetarit të PD-së Sali Berisha nga masa sipas tij e arrestit politik, sikundër krijimi i qeverisë teknike, që do t’i hapë rrugë zgjedhjeve të lira. “Jemi vendi me drejtësi politike sepse lideri i opozitë mbahet i burgosur politikisht. Nuk ka asnjë provë



dhe as fakt dhe ku mbahet i burgosur lideri aty ka trokitur diktatura. Jemi i vetmi vend, anëtar i NATO që nuk zhvillon do zgjedhje të lira”, shtoi ai. Noka tha se PD krahas organizimit të protestës së 11 korrikut, është angazhuar edhe në procesin e bashkimit të demokratëve, ku përjashtim bëjnë sipas tij mercenarët e pushtetit, Basha

dhe Alibeaj. Noka reagoi në intervistën për RTSH-në edhe për akuzat që Basha i ka drejtuar PD-së zyrtare, se është në bashkëpunim me qeverinë. “Është edhe për të qeshur edhe për të qarë sepse një njeri me mendje normale nuk mund të artikulojë këtë. Pazar me Ramën ne, ku ky i fundit na ka sulmuar prej tre vitesh, që na ka përçarë, që na

burgosur liderin, na ka lënë pa fonde ndërkohë që ata i ka bërë miliardë me tendera dhe vazhdo t’u japë tendera”, tha Noka. Ai tha se vetëm një psikiatër mund të shpjegojë gjendjen e Bashës. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm i demokratëve tha se PD mirëpret çdo drejtues dege që ka qenë i mashtuar nga Basha, ndërsa tha se situata apelon që secili opozitar të ngrihet në lartësinë që koha apelon, për të larguar nga pushteti këtë shumicë që ka ngritur sipas tij në sistem kriminel dhe korrupsionin.

Noka sulmon kreun e SPAK

Ndërkohë më herët gjatë një takimi me demokratët në Përmet, sekretari i Përgjithshëm i Partisë Demokratike Flamur Noka, u shpreh se me vendimin e Apelit që njohu grupimin e Berishës si PD zyrtare, tashmë demokratët nuk janë më të shitur dhe kapur. Ai ka sulmuar edhe

kreun e SPAK, Altin Dumani, të cilin e ka quajtur “ushtar” të kryeministrit Edi Rama, synimi i të cilit është asgjësimi i opozitës. “Tashmë jemi të pashitur, të pakapur, të pagjunjzuar. Ja dolëm në 3 vite të mbajmë PD dhe opozitën gjallë. Ia dolëm të kthejmë edhe flamurin që na ishte marrë peng. Nuk mjafton vetëm opozita që të luftohet krimi i organizuar dhe të luftohet shpopullimi. Në vendin tonë vetëm opozita është në shërbim të qytetarëve. Ku është drejtësia e re? Ku është Altin Dumani? A ju dha shqiptarëve një përgjegjësi për inceneratorët? A ju dha shqiptarëve ai dhe SPAK një përgjegjësi për inceneratorët? Jo. Dumani nuk ka këllqë të luftojë korrupsionin sepse është peng i Ramës dhe regjimit. I është caktuar vetëm një detyrë, të bëhet krah Ramës për të asgjësuar opozitën”, nënvizoi Noka.

Lulzim Basha: Edi Rama, arkitekti që qëndron në majë të piramidës së korrupsionit, shqiptarët paguajnë 60% të shërbimeve shëndetësore nga xhepi

Kryetari i Demokratëve Euroatlantik, Lulzim Basha, e ka konsideruar si kthim në vendin e krimit takimin e djeshëm të kryeministrit Edi Rama në QSUT. Sipas tij, problemet e sistemit shëndetësor dhe ndalja e abuzimit kërkojnë zgjidhje urgjente, të cilat nuk mund të vijnë nga ai që ka 11 vite që abuzon me shëndetin e familjeve shqiptare. Dhe për këtë si zgjidhje Basha sheh inkurajimin e SPAK në luftën kundër korrupsionit në çdo aspekt dhe alternativën e demokratëve euroatlantik që qytetarëve të mos u shkojnë dëm paratë e sigurimit shëndetësor, por të marrin shërbim në çdo spital që ofrohet shërbimi i nevojshëm. “Pas skandalit çnjerëzor të Onkologjikut, Edi Rama u kthye te vendi i krimit. Me propagandën e tij bajate, u përpoq

të lajë duart me përgjegjësitë, për t’ia lënë ato vetëm mjekëve. Kujtonte me paturpësinë më të madhe Tixhen, ndërkohë që kryetrixhja e pandemisë ishte vetë ai me tenderat sekretë. Me parulla të lodhura dhe kundërthënëse, ku sipas interesit të tij një herë e ka fajin individit, një herë sistemi, ndërsa koka, maja e kësaj piramide korrutive, fletë sikur ka ardhur sot në pushtet. Siç ka bërë me zv. kryeministrin në arrati për korrupsion, me ministra, ish-ministra, kryebashkiakë e ish-kryebashkiakë, edhe këtu u shfaqësua me frazën “përgjegjësia është individuale”. Nuk është aspak i shqetësuar për paragjykimin që në raste të tilla bie mbi mjekë e infermierë, që në kushte jo normale përpiqen me gjithçka për t’u dhënë ndihmë pacientëve. Për ta kemi dhe do

të kemi mirënjohje për jetë. Por Rama ka hallin e tij, sepse ai është arkitekti që qëndron në majë të piramidës së korrupsionit. Rasti i Onkologjikut, ku bëhet pazar me jetën e pacientëve, është vetëm dëshmia më e fundit e degradimit të një sistemi korruptiv, që si në çdo hallkë të zinxhirit drejtues të Ramës, prodhon dhimbje dhe kosto për familjet shqiptare. Sot për t’u hedhur hi syve shqiptarëve ka shpikur menaxherë të huaj. Siç është dëshmuar edhe më parë, pas çdo skemë të tillë është një tjetër plan abuzimi me paratë e shqiptarëve dhe më pak shërbim për ta. A thua se nuk është ky që u premtoi shqiptarëve shëndetësi falas, e sot shqiptarët paguajnë nga xhepi 60% të shërbimeve për shëndetësinë”, shkruan ndër të tjera Basha.

Skandali i Onkologjikut, të premtën deputetët dëgjesë në Komisionin Hetimor me ministren e Shëndetësisë e 2 drejtoresha

Ministria e Shëndetësisë, Drejtoresha e QSUT dhe shefja e shërbimit të Onkologjikut do të thirren në Parlament për një dëgjesë në Komisionin e shëndetësisë ditën e premte, 5 korrik. Vendimi u mor në mbledhjen e djeshme në komision, ku nuk munguan as debatet mes opozitës dhe mazhorancës. Deputetja e PD, Albana Vokshi e konsideroi skandaloz faktin që pacientët nuk bëjnë radioterapi, pasi dera e dhomës bunker ku ndodhet aparatura e akseleratorit linear ka mbetur hapur.

Nga ashpërsimet disiplinore të ndalimi i punësimit në klinika private, masat e publikuara nga ministria Koçiu

Ta përdorësh uniformën e mjekut për të nxjerrë para është krim kundër njerëzimit, Rama “dush të ftohtë” drejtuesve të QSUT-së pas skandalit të Onkologjiku, ministria Albana Koçiu paralajmëron ndryshime të forta në ligj

Rigels SELIMAN

Pas skandalit të Onkologjikut, ku mjekë dhe infermierë të këtij spitali akuzohen se detyronin të çonin drejt klinikave private pacientët me kancer, kryeministri Edi Rama ka thirrur dje në një takim të gjithë shefat e shërbimeve në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” në Tiranë (QSUT). Duke folur krahas ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Albana Koçiu, kryeministri Rama e ka konsideruar megaskandalin që ndodhte tek Onkologjiku, një krim kundër njerëzimit. “Ky spital nuk ka asgjë më pak se spitalet e Europës. Të mos jesh në lartësinë e detyrës është hall i madh, por të kesh marrë diplomën e licencën e të përdorësh uniformën më delikate të shtetit si maskat e bandave për të nxjerrë para me gjakun e ilaçet e të sëmurëve, është krim kundër të gjithë njerëzimit. Koha e heronjve i ka lënë vendin një kohe tjetër”, tha ai. Rama tekta u ndal tek skandalin në Onkologjik, risolli në vëmendje rastin e Tixhes, sanitares që zhvaste pacientët te Sanatoriumi në kohën e COVID-19. Ai tha se dhe klithmat për ‘pushkatim’ për rastin e mjekëve dhe infermierëve tek Onkologjiku, janë të mirëkuptueshme, por duhet të mirëkuptohen sakrificat e mjekëve. “Kur mjekët shkonin në luftë me shpata, ndërkohë që bota kishte shpikur raketat, nuk është mision i pamundur. Po të mos ishin heronjtë në kohën e pandemisë, disa prej të cilëve ishin kolegë tuajt, që vdiqën dhe në krye të detyrës, numri i shqiptarëve që humbën jetën ishte i vogël në krahasim me vendet e tjera. Mjaftoi ekspozimi i një Tixheje, ajo infermierja që iu kërkonte lekë të afërmeve në Sanatorium, që i kishte kthyer ata njerëz



që luftonin në shtratet e vdekjeve, u ndez revoltë ndaj një komuniteti mjekësh në atë kohë. Një “Tixhe” rrëzoi përtokë gjithë sakrificat, deri dhe sublime. Nuk shkonin më as në shtëpi, duke qenë nëna të veshura me bluzën e mjekes dhe infermieres, por rrinin të mbuluar me ato kostumet speciale për t’i bërë hyzmet pacientëve që ishin në shtratin mes jetës dhe vdekjes. S’ka se si të jetë ndryshe në fakt dhe s’ka as s’i të shpëtojnë autoritetet shtetërore nga sulmet. E mirëkuptueshme në dhimbjen e vetë dhe klithma për pushkatim që shfaqet tek tuk që e keni vënë re dhe ju në rrjetet sociale, pavarësisht se nuk jetojmë më në kohën e pushkatimeve. I gëzohem këtyre rasteve për atë lojë me nervat e njerëzve, duke fabrikuar dhe për atë historinë e kobaltit. Ajo është kriminale, krim më vete. Të mbështetur si përditë nga pompat e kanaleve të ujërave të zeza mediatike. Këto janë problematika të ditura”, nënvizoi dje ai.

Ministria Koçiu zbardh masat

Ndërkohë ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Albana Koçiu ka publikuar dje një sërë masash të marra pas ngjarjes në Spitalin Onkologjik të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”. Në takimin e zhvilluar me drejtuesit e shërbimeve në Qendrën Spitalore

Universitare “Nënë Tereza” me praninë edhe të kryeministrit Edi Rama, Koçiu falënderoi prokurorët që sipas saj, hodhën dritë mbi atë zullum të patolerueshëm në Spitalin Onkologjik.

Koçiu shprehu keqardhje për ndotjen e bluzës së bardhë, të gjithë mjekëve e infermierëve të përkushtuar në shërbimin shëndetësor. Ministria e Shëndetësisë renditi një sërë masash që nga ndërhyrjet në Ligjin “Për Urdhërin e Mjekëve” deri te ndalimi që një mjek të ndjekë të njëjtët pacientë në klinikën private që ka hapur vetë apo që punon aty. Më poshtë masat e prezantuara sot nga ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Albana Koçiu:

- Është punuar intensivisht për disa ndërhyrje të shpejta në Ligjin “Për Urdhërin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë” i cili rregullon veprimtarinë e profesionistëve të shëndetësisë dhe përcakton parime, standarde e kriteret për aktivitetin e bluzave të bardha.

- Hapja apo puna në një klinikë private për mjekët e sektorit publik do të vazhdojë deri në momentin kur spitali përkatës do të përfundojë procesin e autonomisë dhe me marrjen e autonomisë kjo do të jetë rreptësisht e ndaluar.

- Mjekët e punësuar në sektorin publik që kanë hapur apo punojnë

në klinika private, si edhe ata që do të duan ta bëjnë këtë më tutje, duhet të marrin një autorizim/leje nga titullari i spitalit ku janë të punësuar. Ky autorizim duhet të konfirmohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe të publikohet në një regjistër publik digjital.

- Do të ndalohet ligjërisht që një mjek të ndjekë të njëjtët pacientë në klinikën private që ka hapur vetë apo që punon aty. Një mjek i cili ndjek pacientë në klinikat shtetërore është në konflikt të hapur interesi nëse kërkon që po këta pacientë të vijnë në klinikën private që ai ka hapur vetë apo punon aty.

- Po menjëherë, mjekët që kanë hapur dhe/ose punojnë në klinika private nuk do të mund të mbajnë asnjë funksion drejtues të asnjë niveli në spitalet publike apo në Universitetin e Mjekësisë.

- Një drejtues në këto struktura duhet t’i dedikohet plotësisht administrimit dhe aktivitetit në strukturën ku i është dhënë një përgjegjësi drejtimi.

- Historia e transferimit të pacientëve në klinikën private nga drejtuesit e shërbimeve publike do të mbarojë menjëherë sapo të miratohet ky ndryshim ligjor.

- Do të krijohet një komision i vetëm shtetëror disiplinor me 5 anëtarë dhe një komision apelimi. Vendimet e këtij të fundit mund të ankimohen në Gjykatën Administrative, por ky ankimim nuk do të pezullojë ekzekutimin e vendimit të komisionit të apelimit.

NDRYSHIME TË MASAVE

DISIPLINORE EKZISTUESE:

Masat disiplinore aktuale do të ashpërsohen ligjërisht si pjesë e kësaj pakete ndërhyrjesh si më poshtë;

- Dërgimi i pacientëve në klinikën private nga mjeku përgjegjës për në shërbimin publik, do të dënohet me gjoja domethënëse për

mjekun dhe për klinikën private që vetë mjeku ka hapur apo punon. Ndërsa përsëritja e kësaj shkeljeje do të shkojë deri në ndalimin e aktivitetit për mjekun apo klinikën private për afate të caktuara.

- Shkelja e rregullit që drejtuesit publike nuk mund të kenë klinika private apo të punojnë në to përveç shkarkimit nga funksioni dhe gjobës domethënëse për mjekun, si dhe gjobës gjithashtu për klinikën private, do të mund të çojë deri në ndalimin e aktivitetit për të dyja palët për afate të caktuara.

- Mosdeklarimi transparent në kërkimin e autorizimit/lejes për punësim në privat do të çojë në heqjen e licencës për ushtrimin e profesionit për afate të caktuara.

- Shkelja e etikës (betimit të Hipokratit) dhe të protokolleve mjekësore, kur nuk ka shkaktuar pasojë do të çojë në ndalimin e kryerjes së disa shërbimeve mjekësore dhe deri në heqjen për afate të caktuara të licencës së ushtrimit të profesionit.

- Shkelja e protokollit mjekësor, kur ka shkaktuar pasojë të lehta do të çojë, përveç pasojave që burojnë nga ndëshkimi i drejtësisë edhe në heqje të licencës së ushtrimit të profesionit për një afat shumë domethënëse.

- Shkelja e protokollit mjekësor, kur ka shkaktuar pasojë të rënda do të çojë përveç pasojave që burojnë nga ndëshkimi i drejtësisë edhe në ndalimin e aktivitetit të mjekut për gjithë jetën.

- Konkretisht, sipas kësaj pike të fundit, individëve që njollosin institucionin, duke shkelur çdo normë e parim jo thjesht profesional, po edhe human, përveç ndëshkimit të merituar nga drejtësia do t’u ndalohet ta veshin bluzën e bardhë për gjithë jetën. Propozime të ngjashme të përshtatura do të bëhen edhe për profesionet e tjera.

Ministria Albana Koçiu: Ndalim me ligj mjekëve të ndjekin të njëjtët pacient tek publiku dhe privati

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Albana Koçiu njoftoi dje në një takim me drejtuesit e shërbimeve në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, ndryshimet ligjore të ardhura si reagim i menjëhershëm nga ngjarja tek Onkologjiku. Koçiu bëri të ditur se pas një pune intensive për disa ndërhyrje të shpejta dhe kuptimplota në ligjin e Urdhërit të Mjekëve, është vendosur që të ketë ndryshime. Hapja apo puna në një klinikë private për mjekët e sektorit publik do të vazhdojë deri në momentin kur spitali përkatës do të përfundojë procesin e autonomisë dhe me marrjen e autonomisë kjo do të jetë rreptësisht e ndaluar. Mjekët e punësuar në sektorin publik që kanë hapur apo punojnë në klinika private, si edhe ata që do të duan ta bëjnë këtë më tutje, duhet të marrin një autorizim/leje nga titullari i spitalit ku janë të punësuar. Koçiu tha se do të ndalohet ligjërisht që një mjek të ndjekë të njëjtët pacientë në klinikën private që ka hapur vetë apo që punon aty. Një mjek i cili ndjek pacientë në klinikat shtetërore

është në konflikt të hapur interesi nëse kërkon që po këta pacientë të vijnë në klinikën private që ai ka hapur vetë apo punon aty. Koçiu deklaroi se mjekët që kanë hapur dhe/ose punojnë në klinika private nuk do të mund të mbajnë asnjë funksion drejtues të asnjë niveli në spitalet publike apo në Universitetin e Mjekësisë. “Historia e transferimit të pacientëve në klinikën private nga drejtuesit e shërbimeve publike do të mbarojë menjëherë sapo të miratohet ky ndryshim ligjor”, deklaroi Koçiu. Gjithashtu, shkelja e rregullit që drejtuesit publike nuk mund të kenë klinika private apo të punojnë në të përveç shkarkimit nga funksioni dhe gjobës domethënëse për mjekun, si dhe gjobës gjithashtu për klinikën private, do të mund të çojë deri në ndalimin e aktivitetit për të dyja palët për afate të caktuara. “Mosdeklarimi transparent në kërkimin e autorizimit/lejes për punësim në privat do të çojë në heqjen e licencës për ushtrimin e profesionit për afate të caktuara. Shkelja e etikës (betimit të Hipokratit) dhe të protokolleve mjekësore, kur

nuk ka shkaktuar pasojë do të çojë në ndalimin e kryerjes së disa shërbimeve mjekësore dhe deri në heqjen për afate të caktuara të licencës së ushtrimit të profesionit”, u shpreh ministria. Koçiu tha se, shkelja e protokollit mjekësor, kur ka shkaktuar pasojë të lehta do të çojë, përveç pasojave që burojnë nga ndëshkimi i drejtësisë edhe në heqje të licencës së ushtrimit të profesionit për një afat shumë domethënëse. Gjithashtu shkelja e protokollit mjekësor, kur ka shkaktuar pasojë të rënda do të çojë përveç pasojave që burojnë nga ndëshkimi i drejtësisë edhe në ndalimin e aktivitetit të mjekut për gjithë jetën. Konkretisht, sipas kësaj pike të fundit, theksoi ajo, individëve që njollosin institucionin, duke shkelur çdo normë e parim jo thjesht profesional, po edhe human, përveç ndëshkimit të merituar nga drejtësia do t’u ndalohet ta veshin bluzën e bardhë për gjithë jetën. Ministria shprehu bindjen se propozime të ngjashme të përshtatura do të bëhen edhe për profesionet e tjera. Koçiu theksoi se disa nga afatet për


masat e shkeljeve janë të pacaktuara pasi bashkë me masat janë ende në diskutim edhe për pak ditë. Në konsultim do të përfshihen edhe përfaqësuesit e institucioneve shëndetësore jo vetëm publike, përpara sesa qeveria të vendosë miratimin e tyre jo me vonë sesa java e tretë e korrikut. Koçiu përsëriti punën e Prokurorisë që hodhi dritë mbi ngjarjen tek Onkologjiku dhe shprehu besimin që ata individë do të marrin dënimin e merituar. Ministria shprehu keqardhjen për bluzat e bardha të përkushtuar dhe të devotshëm, për plagosjen e rëndë morale nga kjo ngjarje, siç e quajti ajo “neveri të madhe”, tekta deklaroi se “shumica e bluzave të bardha nuk janë si ata”. “Ndërkohë që çuarja përpara drejtësisë e atyre individëve shkuli një tumor korrupsioni dhe harbutllëku ekstrem nga Onkologjiku, ne, Ministria e Shëndetësisë dhe Stafi drejtues i QSUT-së duhet të reagojmë duke ndërmarrë masa e hapa konkretë, që në këtë institucion qendror të shërbimit shëndetësor të mos ketë hapësirë për njerëz e praktika abuzive të asnjë natyre”, deklaroi ajo.

aktualitet

Si OSHEE-KESH-OST zhdukën 1.1 mld euro

Skandalet e Belinda Ballukut nuk kanë fund, KESH tender 2.1 mln euro energji me çmim më të lartë se në bursë, blerja në platformë të fshehtë, si "avulluan" 400 mijë euro

2.1 milionë euro i ikën buxhetit të shtetit për blerje energjie edhe pse nuk ka më asnjë krizë energjetike. Vetëm për datat nga 1 deri më 7 korrik, çmimi i tregtimit të energjisë në bursë ka qenë mesterisht 87 euro/kWh, ndërsa KESH ka hapur ofertat për blerjen e energjisë elektrike me çmim prej 108 euro për kilovat orë. Sipas News24, ky çmim nuk është i justifikueshëm në një kohë kur vetëm pak ditë më parë vendi pati reshje të dendura shiu, ndërsa Shqipëria prej vitesh tanimë e ka të mundur mbulimin e mbarë territorit në masën 97% me energji të prodhuar në vend.



me çmime të tilla i rrisin edhe më tej gropat e shkaktuara në buxhetin e shtetit përmes borxheve nga KESH. Më konkretisht, me çmimin që ka blerë KESH në energjinë në platforma të panjohura, me çmim 108 euro për kilovat orë, janë shpenzuar 2,111,135.04 euro. Ndërsa po të blihej me çmimin e referencës së HUPX prej 87 euro/kWh që ishte çmimi mesatar i datës 28 qershor kur u realizua ky furnizim me energji elektrike do të shpenzoheshin 1,712,995.2 euro. Pra, plot 400 mijë euro diferencë, të cilat ikin në drejtim të paditur. Duhet të sjellim në vëmendje se nëse shkëmbimi i energjisë elektrike do të realizohej në bursën

shqiptare ALPEX, vlera totale e paguar do të duhej të ishte shumë herë më e ulët se kaq.

Rezultatet e Procedurës së Blerje energji elektrike për periudhën 01-07 Korrik 2024	
LOT 1	KESH Blerës
	Sasia MWh
	Sasia totale e kontraktuar 19,488
	Çmimet Euro/MWh
	Çmimi më i lartë i kontraktuar 108.33
	Çmimi më i ulët i kontraktuar 106.30
	Çmimi i ponderuar 106.69
LOT 2	KESH Blerës
	Sasia MWh
	Sasia totale e kontraktuar 5,670
	Çmimet Euro/MWh
	Çmimi më i lartë i kontraktuar 104.00
	Çmimi më i ulët i kontraktuar 101.15
	Çmimi i ponderuar 105.02

HUPX DAM	HUPX DM	HUPX ID		
Day ahead market				
28. Jen	29. Jen	30. Jen		
01. Jul				
Base load price	96.23	84.24	51.19	145.04
Change (%)	-17.89%	-12.46%	-39.23%	183.34%
Peak load price	88.75	45.99	21.40	136.83
Change (%)	-21.23%	-43.05%	-53.47%	539.39%
Daily volume (MWh)	87,995.70	94,886.70	94,878.20	90,697.30
Change (%)	8.21%	-3.53%	-0.01%	6.38%
Monthly volume (MWh)				90,697.3

Kësisoj, blerjet me çmime të tilla i rrisin edhe më tej gropat e shkaktuara në buxhetin e shtetit përmes borxheve nga KESH. Për më tepër, tanimë KESH nuk bën të ditur as kompanitë fituese që kanë furnizuar vendin me energji elektrike, duke "minuar" llogaridhënien publike. Blerjet

Për më tepër, tanimë KESH nuk bën të ditur as kompanitë fituese që kanë furnizuar vendin me energji elektrike, duke "minuar" llogaridhënien publike. Auditet e KLSH të publikuara për vitet e mëparshme për OSHEE dhe KESH kanë zbardhur shifra miliona euro lidhur me humbjet jo teknike të cilat janë vjedhjet.

Si OSHEE-KESH-OST zhdukën 1.1 mld euro

Nëse qytetarët e thjeshtë, mes të cilëve edhe pensionistë e invalidë, rrezikojnë të penalizohen deri në burg kur nuk arrijnë të paguajnë energjinë e muajit, për zyrtarët e OSHEE, KESH e OST-së humbjet në miliona duket se nuk janë aspak shqetësim. Madje, si për ironi, miliona euro që mungojnë në arkat e tyre apo që humbin në tendera plot dritë-hije për fituesit, shënohen si "humbje në rrjet" apo "humbje teknike", duke bërë që buxhetit të shtetit t'i mungojë një fond i konsiderueshëm të ardhurash. Paradoksi është se mungesa e këtyre parave vjen në një fushë që konsumohet gjithçka që prodhohet apo blihet. Pra, nuk kemi të bëjmë me asnjë stok, por me keq menaxhim dhe vjedhje. Humbjet duken edhe më të pabesueshme kur përmes shifrave faktohet se në këtë fushë janë investuar miliona euro për të përmirësuar këtë sektor të rëndësishëm.

Çfarë ndodh me KESH, OSHEE dhe OST?

Tre institucionet kryesore të varësisë së Ministrisë së Energjisë, OSHEE, OST dhe KESH, prej kohësh janë përfshirë në një hartë humbjesh të mëdha në dem të buxhetit të shtetit. Këto institucione që duhej të ishin burim të ardhurash janë kthyer në humbës të mëdhenj të parave publike. Nuk janë pak, por 1.1 miliardë euro buxhet nga të cilat, fati i 670 milionë eurove nuk dihet për shkak të bilanceve të padeklaruara nga OSHEE dhe KESH, vetëm për vitin 2021 - 2022. Ndërkohë 257

milionë euro tendera janë dhënë vetëm për një apo dy kompani në garë, ku jo rastësisht njëra prej tyre gjithmonë përjashtohet nga tenderi, duke i hapur rrugën konkurruesit tjetër që mbetet i vetëm për oferta që fitohen zakonisht në 99% të vlerës së fondit limit. Këto fonde të mëdha janë kthyer në një minierë ari për familjarë të ish-krerëve të policisë të përjashtuar nga procesi i vettingut dhe investitorë strategjikë. Pamundësimi i bursës shqiptare për të funksionuar, transaksionet në kundërshtim me ligjin si edhe sherrret ndërinstitucionale për borxhet e pashlyera, janë një pjesë e ajërbergut të parave të shpërdoruara.

Sherri për borxhet 1.1 mld euro dem në buxhet të shtetit

Borxhet mes KESH, OSHEE dhe OST, kanë krijuar prej kohësh një sherr ndërinstitucional, ku palët janë të ndarë në pretendimet e tyre. Në këtë përplasje, fillimisht OSHEE do të deklaronte se borxhi ishte 104 milionë euro ndërsa OST pretendonte se ishte 129 milion euro. Diferenca prej 25 milionë eurosh ishte burimi i konfliktit për detyrimet që kompanitë kishin ndërmjet njëra-tjetrës. Sipas burimeve zyrtare të emisionit "Vetting" zbulon se në 15 prill 2021 ndërmjet OSHEE dhe OST u firmos marrëveshja për pagesën e detyrimeve të prapambetura me vlerë 9,68 miliardë lekë ose 96 milionë euro. Nga informacionet e Ministrisë së Financave, përplasia midis OST dhe OSHEE vazhdon pasi në projekt buxhetin 2024 nënvizohet se detyrimet janë nga 9 miliardë lekë deri në 18.3 miliardë lekë të OSHEE-së ndaj OST-së, e thënë ndryshe 90 deri në 183 milionë euro pasi kompanitë publike akoma nuk bien dakord me njëra-tjetrën. Ngelet shqetësues fakti dhe krijohen dyshime për abuzime pasi bilancet nuk pasqyrohen dhe fondet i mungojnë buxhetit, ndërsa palët ende kundërshtojnë njëra-tjetrën, duke mos qenë transparente.

Këshilltari për çështjet ekonomike në PD: 1/3 e shqiptarëve kanë ikur nga vendi në 11 vite. Ndërtimi rritje dyshifrore, edhe pse 365 mijë banesa janë bosh

Këshilltari për çështjet ekonomike në PD Dorian Teliti, me anë të një deklarate për mediat tha dje se 1/3 e shqiptarëve kanë ikur nga Shqipëria në 11 vitet e fundit. Teliti theksoi se ndërtimi ka pasur rritje dyshifrore, duke shtuar se 365 mijë banesa janë bosh. "Të dhënat e Censusit të publikuar pak ditë më parë nuk janë reale. Sipas Eurostat, gjatë 11 viteve të fundit, largimi i shqiptarëve ka qenë masiv, mbi 900 mijë shqiptarë janë larguar dhe me konkretisht, 478 mijë shqiptarë janë larguar me dokumente të rregullta, 192 mijë shqiptarë kanë kërkuar azil në vendet e BE-së, dhe 311 mijë shqiptarë qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në Europë, pa përfshirë këtu vende si SHBA, Kanada, Britaninë e Madhe, Australi, etj. Të nderuar qytetarë. Ndonëse 1/3 e shqiptarëve janë larguar

nga vendi këto 11 vite, ekziston një sektor i cili krizë nuk njeh, përkundrazi, vazhdon të shënojë rritje marramendëse, dhe ai është sektori i ndërtimit, i betonit që derdhet lum çdo ditë e më shumë. Sipas OECD, Eurostat dhe Instat, 356 mijë banesa janë aktualisht bosh, të pabanuara, ku pjesa më e madhe e tyre nuk janë në fshatrat e braktisur apo në zona rurale, por janë në qytete, me plot 180 mijë apartamente të pabanuara. Çfarë po ndodh? Ndërkohë që kemi kaq shumë apartamente të pabanuara, pse ndërtimi vazhdon të rritet me ritme dyshifrore? Si është e mundur që me gjithë këtë ofertë të lartë, çmimet në vend që të uleshin e të ishin më të përbalueshme për familjet dhe çiftet e reja, ato rriten me shpejtësi vit pas viti? Si është e mundur që ndonëse 40% e pallateve të ndërtuara vitet e fundit në Tiranë

janë bosh, ndërtimi për kulla dhe pallate shumë katëshe vazhdon me ritme të larta? Si është e mundur që nuk ka asnjë kontroll qeveritar për burimin e financimit të këtyre viteve, ndërkohë që nuk ka mbetur institucion ndërkombëtar pa ngritur shqetësimin e përdorimit të parave nga burime të dyshimta apo të pastrimit të parave në sektorin e ndërtimit? Ka vetëm një shpjegim, që i gjithë ky operacion "quasi spastrimi" të shqiptarëve dhe kthimin e vendit në një arenë pastrimi parash në sektorin e ndërtimit, janë politikë e vetë qeverisë, e konceptuar, menaxhuar, sponsorizuar po nga vetë qeveria në fuqi, me qëllimin okult të largimit të shqiptarëve nga vendi dhe mbretërimi përjetësisht në pushtet njësoj si paraardhësit e tyre të regjimit komunist", tha ai.

Skemat lehtësuese, Rama: Fermerët shtuan sipërfaqet e mbjella me kultura bujqësore

Investimet për rehabilitimin e sistemit të ujitjes dhe kullimit kanë ripërtërit sipërfaqet të tëra tokash bujqësore, ndërsa skemat mbështetëse nga qeveria kanë nxitur fermerët të shtojnë sipërfaqet e mbjella. Kryeministri Edi Rama ndau dje pamje në rrjetet sociale nga korrija e grurit në njësinë administrative të Katundit të Ri, ku dhe theksoi se është shtuar sipërfaqja e mbjellë me drithë. "Falë skemave lehtësuese në mbështetje të fermerëve si dhe investimeve për pastrimin dhe rehabilitimin e kanaleve kulluese e vaditëse, sipërfaqet e mbjella me kultura të ndryshme bujqësore janë shtuar këtë vit. Korrija e grurit në njësinë administrative të Katundit të Ri ku është shtuar sipërfaqja e mbjellë me drithë", deklaroi Rama. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural thotë se është e angazhuar të mbështesë fermerët dhe njësitë agropërpunuese përmes politikave të prodhimit, agropërpunimit dhe Skemës Kombëtare të Naftës, ku sipas saj, gjatë këtij viti 1/3 e fermerëve që kultivojnë grurë kanë aplikuar për naftë falas. Instituti i Statistikave (INSTAT) publikoi së fundmi raportin mbi statistikën e bujqësisë, sipas të cilit prodhimi i drithërave në vitin 2023 është 701.314 tonë, ndërsa qarku i Fierit ka nivelin më të lartë me 176.584 tonë, pasuar nga qarqet Elbasan me 95.572 tonë dhe Korçë me 83.889 tonë.

Zbardhen aferat ku implikohet Karçanaj

Skandalet te AKSHI, a është blerë Prokuroria që po heton Mirlinda Karçanajn nga grupet e interesit, si prokurorët po çojnë hetimet drejt kalendave greke

Linda Karçanaj, drejtoresha e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) vazhdon të amnistohet nga drejtësia. Ka dyshime të forta se grupe interesi që marrin tendera dhe janë përfshirë bashkë me Karçanajn në afera, kanë ndërhyrë te drejtësia që ajo mos të marrë asnjë masë edhe pse AKSHI është shndërruar si një gropë thithëse që vetëm shpërdoron taksat tona dhe shpërndan tendera të dyshimtë. Dosja "e zezë" e drejtueses së AKSHI-t sa vjen dhe zgjerohet. Në këtë artikull po renditim vetëm majën e ajsbergut të korrupsionit galopant që ka mbërthyer këtë institucion dhe si prokurorët po çojnë hetimet drejt kalendave greke.

Karçanaj në SPAK

Edhe pse drejtoresha e AKSHI-t është paraqitur para disa muajsh para prokurorëve specialë për të dhënë sqarime rreth padisë që i është bërë për dëmtimin e të dhënave masive të qytetarëve shqiptarë, si pasojë e mos-ndarjes së serverave pas sulmit kibernetik që ka goditur vendin tonë, asnjë lëvizje nuk ka ndodhur deri më tani nga Prokuroria e Posaçme. Hakerat madje vazhdojnë të publikojnë të dhënat tona, ku para disa ditësh nxorën karta identiteti,



numra dhe targa. Gjithashtu SPAK po zvarrit hetimet edhe për tenderin e AKSHI-t për abuzime me fondet publike lidhur me 1.7 milionë euro. Nëse dosja qepet siç duhet, Karçanaj rrezikon deri në 3 vite burg. Matlija tha se kur vjen puna te prokurimet publike dhe tenderat është pika më e errët nga të gjitha organet e çështjes dhe në mënyrë të veçantë të procesit ekzekutiv. Kujtojmë se 1.7 miliardë lekë i ka ofruar Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit subjektit "Spot Communications" për të reklamuar portalin e- Albania. Drejtuesja e AKSHI-t, Mirlinda Karçanaj ka nxituar të firmosë kontratën me "Spot Communications", duke

mbyllur sytë para shkeljeve që u bënë në tender. Është ky thelbi i denoncimit të bërë pak kohë më parë nga "Ora investigim", e cila publikoi fakte për kompanitë pjesëmarrëse në tender që kanë pasur lidhje me njëra-tjetrën. Karçanaj edhe në këtë rast si është futur "gjemb" në këmbë. Nga ana tjetër, në mars të këtij viti ajo është thirrur për herë të dytë në SPAK. Mësohet se Karçanaj u pyet lidhur me në lidhje me hetimet mbi ish-kreun e Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH), Evis Berberin dhe tenderat e mirëmbajtjes së serverëve të ARRSH. Deri më tani asnjë lajm mbi Karçanajn nga SPAK. Po ashtu, pak kohë më parë për shkak të

abuzimeve me dy tendera, atë të laboratorëve smart në shkolla dhe mbikqyrjen e burgjeve, në zyrat e AKSHI-t zbankuan hetuesit e BKH, të cilët sekuestruan masivisht kompjutera dhe celularët e shumë punonjësve. Por drejtuesja e AKSHI-t u la jashtë këtij aksioni.

Skandalet

Na gjeni një drejtuese në botë që do t'i shpëtonte këtyre skandalave, apo dhe të vazhdonte të qëndronte në krye siç po vepron Mirlinda Karçanaj edhe pse nxori sheshit të gjitha të dhënat private të çdo shqiptari. Linda po e turpëron përditë shoqërinë tonë me nivelin e ndërgjegjes, logjikës së saj qorre e shurdhe duke u justifikuar gjithmonë kur plasin skandalet. Gjëja më e qartë deri në këto momente është papërgjegjshmëria. Ka ndodhur gjëma dhe askush nuk ka përgjegjësi. Askush. Madje Karçanaj ka mësuar nga udhëheqësit e saj që e mbajnë akoma në krye të këtij institucioni me argumentin se këto gjëra ndodhin kudo. "U kanë ndodhur vendeve dhe shteteve më të fuqishme se ne. Kanë ndodhur edhe më parë. Do të ndodhin sërish. Po ndodhin çdo ditë." Rama duhet ta shkarkonte menjëherë Karçanajn nga detyra që në momentin kur u publikuan listat e pagave të të gjithë shqiptarëve.

Ajo nuk e dha dorëheqjen pasi tha se nuk ka asnjë përgjegjësi për publikimin e listës së pagave dhe kreu i qeverisë nuk mori asnjë masë për këtë skandal të madh që shkaktoi "tërmet" në opinionin publik. Jo vetëm kaq, por masa e saj duhet të ishte më e rëndë kur plasi skandali i patronazhistëve. Të dhënat personale duhet të mbrohen me ligj dhe institucionet shtetërore e kanë detyrim ligjor për ti mbrojtur ato. Karçanaj, dështoi dhe socialistët që i kanë siguruar nga AKSHI, apo diku tjetër të dhënat personale duhet të mbanin përgjegjësi. Jo vetëm kaq, por shkarkimin urgjent ajo duhet ta merrte nga tenderat e dyshimtë që ka dhënë, pasi ato janë kthyer në monopol dhe i fitojnë të njëjtat kompani. Le ta marrim të mirëqenë se AKSHI-t po i bie në qafë. Le ta marrim të mirëqenë po ashtu se AKSHI nuk ka asnjë përgjegjësi për patronazhistët, për rrjedhjen e të dhënave dhe skandalet e tjera dhe fajtorët kryesorë janë hackerat. Po për lekët e taksapaguesve shqiptarë si do i bëhet? Kush do të mbajë përgjegjësi nëse fajtoresha nuk është Karçanaj e cila është shndërruar si një monument kulture që vazhdon të mbrohet nga Edi Rama dhe grupe të tjera interesi?

"Zbehet" besimi në ecurinë e ekonomisë, të gjithë sektorët në rënie, tregtarët presin më pak punë dhe çmime të larta

Treguesi i ndjesisë ekonomike, një indeks i përmuajshëm i Bankës së Shqipërisë, regjistroi rënie me 2.6 pikë në muajin qershor, por që gjithsesi qëndron mbi mesataren historike. Rënia këtë muaj u ndikua kryesisht nga dobësimi i treguesve në sektorin e tregtisë, të shërbimeve dhe të ndërtimit. Në një masë më të vogël ndikoi edhe rënia e besimit në sektorin e industrisë dhe besimit të konsumatorit. Treguesi i besimit në tregti regjistroi rënie më të madhe me 4.8 pikë përqindje, ndikuar kryesisht nga vlerësime në rënie të ecurisë aktuale të biznesit dhe pritjeve për punësimin. Pritjet për ecurinë e biznesit në të ardhmen regjistruan gjithashtu rënie, kundrejt pritjeve në rritje për çmimet në të ardhmen. Sipas SCAN, treguesi i besimit në shërbime ra me 3.8 pikë përqindje, ku kontribuan vlerësimet më pak optimiste të bizneseve për ecurinë

aktuale të aktivitetit të tyre. Pritjet e bizneseve për punësimin dhe çmimet në të ardhmen janë me rritje. Treguesi i besimit në ndërtim ra me 2 pikë përqindje, përcaktuar kryesisht nga vlerësimet në rënie për aktivitetin aktual ndërtues dhe kontratat porositëse. Gjithashtu, pritjet për çmimet që do të vendosin në të ardhmen kanë regjistruar rënie, ndërsa ato për punësimin paraqiten në përmirësim. Treguesi i besimit të industrisë ra lehtësisht me 0.4 pikë përqindje në muajin qershor, i ndikuar nga vlerësimet më pak optimiste për kontratat porositëse vendase dhe të eksportit. Pritjet e bizneseve të këtij sektori për punësimin në të ardhmen kanë regjistruar rënie, ndërsa e kundërta ka ndodhur me pritshmëritë e çmimeve të produkteve në të ardhmen. Treguesi i besimit konsumator regjistroi një rënie të lehtë me 0.4 pikë përqindje, duke

zbritur afër nivelit të mesatares historike. Konsumatorët vlerësuan me rënie situatën e tyre financiare dhe situatën ekonomike të vendit në të ardhmen. Vlerësimi i tyre për blerjet në shuma të mëdha ra lehtë në muajin qershor. Ndërkohë, pritjet për nivelin e përgjithshëm të çmimeve në të ardhmen janë rishikuar për poshtë. Të dhënat me frekuencë tremujore tregojnë se gjendja financiare e bizneseve dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve të tyre është rritur në tremujorin e dytë, në krahasim me tremujorin e parë të vitit 2024. Në veçanti, në sektorët e industrisë dhe shërbimeve balanca e gjendjes financiare është zgjeruar me 7.7 pikë përqindje krahasuar me atë të një tremujori më parë. Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve është rritur gjithashtu, në krahasim me tremujorin e parë, në të gjithë sektorët e biznesit.

Inovacioni, udhëheqin shërbimet, bizneset e vogla më të shpejtat në zhvillimin e produkteve

Shërbimet janë pararojë e inovacionit ku të dhënat zyrtare tregtinë se ndërmarrjet që përfshihen në këtë kategori kanë dhënë një fokus më të madh në këtë aspekt. Publikimi "Aktiviteti i inovacionit në ndërmarrje" i Institutit të Statistikave tregon se aktiviteti i inovacionit në ndërmarrjet e sektorit të shërbimeve ishte 46 % ku ndërmarrjet në aktivitetin e Informacionit dhe Komunikacionit kanë rezultuar aktive në Inovacion me 67,3 %, ndërmarrjet në aktivitetet Financiare dhe të Sigurimit me 52,7%. Në total publikimi tregon gjatë periudhës 2020-2022, 42,9 % e ndërmarrjeve të vrojtuar kryen një aktivitet Inovacioni. Krahasuar me të dhënat e vrojtimit të mëparshëm të inovacionit me periudhë referuese 2018-2020,

aktiviteti i inovacionit u rrit me 6,3 % (nga 36,6 % në 42,9 %). Por si qëndron inovacioni në sektorë të tjerë përpos shërbimeve? Sipas INSTAT në sektorin e Industrisë aktiviteti i Inovacionit rezultoi me 39,3 % ku ndërmarrjet në aktivitetin e Energjisë elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër të kondicionuar kanë rezultuar aktive në Inovacion me 44,4 %, në Industrinë Përpunuese me 42,0 %. E fundit në listë është industria nxjerrëse me 18 për qind. Gjetjet e INSTAT nënvizojnë se ndërmarrjet në sektorin e industrisë shënojnë një rritje më të lartë në aktivitetin e inovacionit me 7,2 pikë përqindje ndërsa ndërmarrjet në sektorin e shërbimeve shënojnë një rritje me 5,0 pikë përqindje krahasuar me të dhënat e periudhës së mëparshme.

Pas rritjes së pagës minimale, pritet rritja e pensioneve

Hyn në fuqi rritja e pagave për 135 mijë punonjës të administratës publike, ja sa do rriten rrogat për çdo kategori, zbardhet lista e plotë me shtesat, lajme të mira edhe për të moshuarit, pensioni minimal pritet të shkojë 15.000 lekë, çfarë do të ndodhë në vjeshtë

Xhoana VRANIÇI

Hyri në fuqi ditën e djeshme (1 Korrik) rritja e pagës për 135 mijë punonjës të administratës shtetërore, konkretisht punonjësit e sistemit arsimor parauniversitar, punonjësit e sistemit shëndetësor, punonjësit e sistemit të sigurisë së vendit (Policia e Shtetit, Policia e Burgjeve, Garda e Republikës, Forcat e Armatosura, Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi) si edhe punonjësit e nivelit zbatues dhe mbështetës të administratës shtetërore.

Detajet

Por sa lekë do të marrin shtesë këta punonjës? Rritja për Forcat e Armatosura do të vijojë nga 7% deri në 22%, ku rritja më e madhe do të jetë tek ata që kanë pagën më të ulët. Për zjarrfikësit është parashikuar rritje pagash deri në 30%, ndërsa për punonjësit e burgjeve rritja nis nga 13% deri në 27%. Ndërsa për mësuesit rritja është nga 20 mijë lekë deri në 22.8 mijë lekë sipas nivelit arsimor, dhe për punonjësit e shëndetësisë rritet me 20 mijë lekë rroga për mjekët dhe me 15 mijë lekë për infermierët. Me këtë rritje pagash të miratuar më 26 qershor 2024 paga mesatare në sektorin shtetëror arrin në 105 mijë lekë. Për këtë rritje të pagave, që është e fundit e reformës së ndërmarrë nga qeveria në vitin e kaluar, vetëm për periudhën korrik-dhjetor 2022 nga buxheti i shtetit do të shpenzohen afro 108 milionë



euro për rritjen e pagave. Fatura do të rritet më tej në vitin e ardhshëm pasi për të mbajtur këtë nivel të ri pagash nga buxheti i shtetit do të shpenzohen afro 390 milionë euro. Paralelisht me këtë rritje, prej 1 janarit 2026, të gjitha pagat e sektorit shtetëror do të indeksohen me normën e inflacionit. Indeksi i rrogave të administratës do të bëhet një herë në dy vite.

Rrogat e reja të Forcave të Armatosura

	ISHTE	BËHET
Ushtari	58.000 lekë	71.000 lekë
Rreshteri	62.660 lekë	80.000 lekë
Majorit	89.440 lekë	107.000 lekë
Koloneli	143.000 lekë	163.500 lekë
Gjenerali	165.000 lekë	190.000 lekë

Rrogat e reja të shërbimit zjarrfikës

	ISHTE	BËHET
Asistent zjarri	46.000 lekë	60.000 lekë
Zjarrfikës	52.500 lekë	65.000 lekë
Kryezjarrfikës	55.000 lekë	70.000 lekë
Kryeinspektor	74.500 lekë	85.000 lekë
Inspektor	64.200 lekë	75.000 lekë
Komisar	97.500 lekë	105.000 lekë
Drejtues	108.000 lekë	115.000 lekë
Drejtues i parë	120.000 lekë	140.000 lekë
Drejtues i lartë	131.000 lekë	160.000 lekë

Rritja e pagave në shëndetësi

Mjekët	+20 mijë lekë
Infermierët	+15 mijë lekë
Administrata shëndetësore	+15-20%

Rritja e pagave në arsim

	ISHTE	BËHET
Mësuesit në arsimin e mesëm të lartë	79 mijë lekë	98.5 mijë lekë
Mësuesit në arsimin e mesëm të ulët	75.8 mijë lekë	96 mijë lekë
Mësuesit në ciklin fillor	72.4 mijë lekë	95.2 mijë lekë

Punonjësit e burgjeve

Aspirantët për Policinë e Burgjeve	80% të pagës së inspektorit
Punonjësit e burgjeve	rritje nga 6 mijë deri në 33.6 mijë lekë

Pensionet

Por lajme të mira ka edhe për pensionet. Pas rritjes së pagave në administratë, të gjithë pensionistët janë në pritje të

indeksimit të pensioneve. Qeveria ende nuk ka njoftuar se kur do të ndodhë, por pritshmëritë janë gjatë vjeshtës, kohë kur pritet të marrë formë edhe skema e re e pensioneve për të cilën po negociohet me Bankën Botërore. "Nuk duhet të ngatërrojmë indeksimin, i cili nuk është rritje si dhe bonusin e fundit vitit. Këto janë parashikuar në ligjin e buxhetit. Ajo që është si pritshmëri është rritja e pensioneve. Qeveria dhe ministria po detajon një skemë të re, që në fokus do të jenë pensionet e ulëta. Sikundër u rrit paga minimale, fokusi do të jetë rritja e pensionit minimal", tha deputetja e PS Pranvera Resulaj. Por pak kohë më parë ministri premtoi se do të ketë një paketë shtesë për shtresat në nevojë. Kur pritet të konkretizohet? "Ecuria e mbledhjes së të ardhurave duket e kënaqshme. Turizmit pritet të japë një hov edhe më shumë në këtë drejtim. Në përfundim të sezonit turistik do të shihen treguesit e buxhetit për të vendosur masën e paketës mbështetëse. Shifrat janë pozitive ndaj dhe paketa do të jetë e kënaqshme", sqaroi Resulaj. Vizion Plus ka mësuar se në fokus të negociatave për skemën e re të pensioneve janë pensionet minimale. Ideja është që të mos ketë pension nën 15.000 mijë lekë në muaj, por kjo mbetet për t'u konkretizuar brenda vitit duke bërë dhe një diferencim të pensioneve në fshat dhe qytet, si dhe të rezidentëve brenda dhe jashtë vendit, ku prioritet do të kenë ata që jetojnë në Shqipëri.

Çdo shqiptar tani është automatikisht 1300 euro më i pasur në letra

në mbi gjysmën e balotazheve, disa parti po hartojnë strategji për të bllokuar të djathtën ekstreme. Ata nuk kanë shumë kohë, pasi kandidatët duhet të vendosin nëse do të konkurrojnë apo jo deri sonte mbrëma. Fronti i Ri Popullor i krahut të majtë ka njoftuar se do të tërheqë të gjithë kandidatët që dolën në vendin e tretë për të ndihmuar në parandalimin e zgjedhjes së ekstremit të djathtë. Në fund të fundit, gjithçka mbetet vetëm një udhëzim – tërheqja ose jo varet nga kandidatët individualë dhe votuesit do të bëjnë zgjedhjet e tyre. Presidenti Emmanuel Macron u tregua gjithashtu i hapur ndaj metodës, duke kërkuar që të studiohet situata e çdo zone për të gjetur aleanca, madje edhe me kandidatët e La France Insoumise, për të bllokuar Asamblenë Kombëtare të Marine Le Pen dhe Jordan Bardella.

Pakënaqësi në Bruksel

Në Bruksel, përshpejtimi i dhënë nga partitë tradicionale për të parashikuar goditjet që mund të vijnë nga fitorja e Marine Le Pen në Francë, ka krijuar shumë pakënaqësi, veçanërisht në grupet më të vogla të familjeve të mëdha evropiane. Arroganca e qeverive të lëkundshme si ajo gjermane dhe spanjolle apo edhe gjatë zgjedhjeve si ajo franceze, nuk u pëlqeu atyre partive që bëjnë pjesë në grupimet tradicionale të pranishme në Bruksel, si dhe atyre që nuk janë të paktë - që pavarësisht se kanë dalë fitues nga zgjedhjet, e gjejnë veten të marginalizuar nga zgjedhjet. Partia RN e dojenës së ekstremit të djathtë, Marine Le Pen, është jashtëzakonisht euroskeptike dhe megjithëse nuk flet më për një "Frexit" të plotë, apo largim francez nga Bashkimi Evropian, manifesti i saj vë në pikëpyetje vetë themelet e projektit evropian. RN e ka bërë të qartë se do të përpiqet të dobësojë bashkimin dhe të rifitojë më shumë kontroll mbi kufijtë dhe sovranitetin e saj. Pasi në pushtet, dhe me Giorgia Meloni të Italisë dhe Viktor Orban të Hungarisë si aleatë të ekstremit të djathtë, planet e tyre për Evropën mund të kenë shumë më tepër peshë. Nëse RN dominon parlamentin, do të jetë gjithashtu një lajm i mirë për presidentin rus Vladimir Putin.

Hungaria merr kryesimin e BE-së

Hungaria, mori drejtimin për 6 muajt e ardhshëm të Presidencës së BE. Prej ardhjes në pushtet, në vitin 2010, qeveria hungareze është përplasur shpesh me Brukselin duke kundërshtuar politikën e përbashkëta evropiane për emigracionin, sanksionet kundër Rusisë dhe trysinë mbi Budapestin për nivelin e demokracisë në vend. Sipas analistes hungareze Dorka Takacs, udhëheqësit evropianë presin që gjatë gjashtë muajve të ardhshëm, presidenca hungareze të shkaktojë vonesa të qëllishme sidomos për vazhdimin e negociatave për anëtarësim të Ukrainës në bllok. Pavarësisht kësaj, zyrtarët e qeverisë hungareze janë zotuar se ata do të punojnë në favor të zgjerimit të BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor. Qeveria e Hungarisë është zotuar se do të jetë një "ndërmjetës i ndershëm", siç shprehet ajo, pavarësisht shqetësimeve mbi atë që kritikët e shohin si një qeveri autoritare dhe miqësore ndaj Rusisë. Kryeministri nacionalist hungarez Viktor Orban, i cili e ka drejtuar shtetin e Evropës Qendrore që nga viti 2010, shpesh përplasat me Brukselin për çështjet e sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut. Ndër çështjet që Hungaria i ka përcaktuar si prioritet është zgjerimi i BE në Ballkanin Perëndimor.

Rriten incidentet islamike në shkollat në Gjermani


Kërcënime me bomba, njoftime për sulme, fyerje antisemite dhe një atmosferë e nderur: Pasojat e konfliktit të Lindjes së Mesme ndjehen edhe në shkollat gjermane. Një sondazh i platformës kërkimore Vollbild të shërbimit publik gjerman SWR, i kryer në Ministrinë e Brendshme dhe të Arsimit në lande, tregon se në Gjermani vihet re një radikalizim i dukshëm i nxënësve si dhe një rritje e numrit të incidenteve ekstreme në shkollat. Por edhe se gjithnjë e më shumë raportohet për një atmosferë të tensionuar në klasa. Kështu, Ministria e Arsimit e Hessenit raporton një rritje të ndjeshme: Që nga viti 2018, janë regjistruar 15 incidente me motive islamike në shkollat, nga të cilat 14 në vitin 2023. Nga këto, 11 raste ishin të lidhura "në kohë dhe tematikë" me sulmin terrorist të Hamasit në Izrael. Gjashtë raporte u referohen kërcënimeve anonime me bomba në shkollat në Hessen. Megjithatë, numri i incidenteve në vitin 2024 është ulur sërish në krahasim me vitin 2023. Ministria e Arsimit e në Renania Palatinat bëri të ditur se nuk mund të anashkalohet fakti që atmosfera është "më e tensionuar dhe më e nxehtë" sesa ka qenë. Edhe pse nuk ka rritje të incidenteve, ka pasur kërcënime individuale për të sulmuar shkollat.

k o m e n t e & a n a l i z ë

Aktorët përgjegjës, për rezultatet e dobëta në provimet e maturës dhe minimaturës

Nga Saba LAMA

Dihet tashmë që Matura Shtetërore dhe Minimatura, janë dy provime të rëndësishme që funksionojnë në shkollat arsimi parauniversitar. Këto dy provime, si qasje



të vendëve me arsim të përparuar evropiano-perendimor, ka vite që funksionojnë edhe në vëndin tonë dhe për mbarëvajtjen e tyre janë angazhuar shumë aktorë dhe struktura arsimore në nivele qendrore (MASR, QSHA), në nivele rajonale (Drejtoritë Rajonale Arsimore) dhe në nivele lokale (Zyrat Vëndore Arsimore). Provimet e Maturës Shtetërore që zhvillohen në arsimin e mesëm të lartëpër lëndët: Gjuhë Shqipe dhe Letërsi, Matematikë, Gjuhë e huaj dhe Lëndën me zgjedhje dhe ato të Minimaturës që zhvillohen në arsimin e mesëm të ulët (arsimin bazë) për lëndët: Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Gjuhë e huaj, synojnë të eksplorojnë dhe të masin njohuritë e nxënësve sipas lëndëve që përmban çdo provim. Rezultatet e këtyre provimeve nga viti në vit, kanë treguar se ato janë në nivele të ulta, madje tepër të ulta. E një rezultat i tillë u reflektua edhe në provimet e Maturës dhe Minimaturës së këtij viti, bazuar në të dhënat statistikore të të gjitha shkollave që u angazhuan në këto provime. Pra nisur nga rezultatet, po ndodh i njëjti skenar nga viti në vit. Por rezultati i përsëritur, na kujton shprehjet që përdor populli në zhangonin e tij: "Po nuk dhe atë që duhet, nuk merr atë që don", ose shprehjen tjetër "Ç'ka do të mbjellësh atë do të korrësh". Po kush janë ata që e mbjellin këtë farë, që marim këtë korrje dhe këtë produkt? Pra kush janë ata aktorë që bëhen përgjegjës të këtij produkti të marë në vazhdimësi. Në këtë drejtim mendoj se janë:

1. Mësuesit. Po kush janë mësuesit e sotëm që mësojnë fëmijët tanë dhe që u është besuar detyra fisnike dhe humane si mësime dhe edukator? Janë ata ku disa prej tyre, e kanë marë diplomën për mësuesi pa merita profesionale por me rrugë abuzive, pasi këtë hapsirë dhe mundësi ia lejoj periudha e tranzicionit demokratik shqiptar. Janë ata të cilët nuk e ndiejnë përgjegjësinë për mësime dhe njohuritë që u japin nxënësve të tyre gjatë procesit mësues, që dijnë dhe dhëna të jenë të qëndrueshme për nxënësit për t'u shërbyer atyre nesër kur të dalin në jetë. Kjo mungesë përgjegjësie e tyre, shprehet në përgatitjen e përditëshme ditore që bëjnë, përgatitjen e cila është formale dhe sa për të kaluar rradhën, por në gjirin e mësuesve të sotëm ka edhe nga ata që shkojnë krejtësisht të papërgatitur në shkollë, lidhur me materialin e ri mësues që do t'u shpjegojnë nxënësve. Sot nisur nga praktika, janë të pakët apo shumë të pakët ata mësues që e ndjenë përgjegjësinë për misionin që kanë, kjo mund të ndodhë të mësuesit që kanë sedër dhe

ambicie profesionale dhe tek ata që e kanë me pasion profesionin e nderuar të mësuesit. Në gjirin e mësuesve të sotëm, kemi edhe nga ata të cilët e shfrytëzojnë profesionin e tyre në raportet me nxënësit për t'i shfrytëzuar këta të fundit për interesat e tyre veti nga më të larmishmet. Mësuesit e sotëm nisur nga performanca negative që shpalosin në shkollë, po ua bëjnë nxënësve të mërzitshme shkollën, që është edhe një nga shkaqet e braktisjes së saj nga nxënësit e sotëm (krahas të tjerave) siç kanë treguar rastet, pasi nuk ndjehen mirë nga veprimtaria mësimore-edukative e mësuesve që shkolla të bëhet e dashur për nxënësit.

2. Nxënësit. Sigurisht që edhe ju nxënës keni përgjegjësinë tuaj lidhur me rezultatet e dobta të përjetuara në provimet e Maturës dhe Minimaturës. Kjo përgjegjësi reflektohet në: mungesën e interesit që tregoni në përmbushjen e detyrave që u takojnë si nxënës. E këtu është fjala në përgatitjen e përditëshme që ju duhet të bëni në lëndët mësimore që zhvillohen sipas cikleve të shkollimit. Shumica e nxënësve sot, e kanë braktisur tekstin shkollor, që duhet ta konsiderojnë kurdoherë si burimin kryesor për të marë dijen dhe informacionin e nevojshëm, pavarësisht se shumica e mësuesve të sotëm siç lartpërmendëm, nuk po e ndiejnë përgjegjësinë dhe përkushtimin për t'ju shpalosur nxënësve në orën mësimore një cilësi mësimdhënie në nivelin që kërkohet. Ajo që vlenë për të nënvizuar, është se edhe ju nxënës sot po e konsumoni më shumë kohën përmes përdorimit të celularit apo të ndonjë mjete tjetër elektronik, për gjëra të panevojshme. Pra ju, duhet ta kuptoni se po abuzoni me veten tuaj, me perspektivën tuaj nga mungesa e interesit për t'i shfrytëzuar tekstet shkollorë në kohën e duhur për moshën që keni, në drejtim të përgatitjes suaj për t'u arsimuar. Madje apeli që doja t'u bëja lidhur me këtë abuzim, është se do j'u kushtoj shumë shtrejnjtë nesër kur të dilni në jetë, nga mangësitë dhe boshllëqet e ndjeshme të krijuara gjatë viteve të shkollimit. E nëse ju nuk do vlerësoni shkollimin dhe marrjen e njohurive në moshën kur jeni, nuk do jeni më në gjendje nesër t'a riktheni kohën e humbur (për mësime që keni marë nga mospërgatitja juaj), pasi koha shkon përpara dhe ne duhet t'ishkojmë pas asaj, sipas detyrave që na dikton, e nëse nuk e bëjmë këtë, edhe ajo (koha) do të na lërë pas neve.

3. Prindërit e nxënësve. Pa dyshim që edhe ju prindër, keni detyrat dhe përgjegjësitë e tua në drejtim të ndihmës dhe të bashkëpunimit me mësuesit, për mbarëvajtjen e fëmijëve tuaj në shkollë. Jo pa qëllim prindi, nga specialistët dhe ekspertët e pedagogjisë, është konsideruar dhe vlerësuar si mësuesi i parë i fëmijës. Koha ka treguar se ju ka vite që jeni distancuar nga ndjekja e mbarëvajtjes së fëmijëve në shkollë. Kynënvlerësim dhe qëndrim i juaj, ka sjellë edhe devijimin e fëmijëve nga kontrolli juaj si prind, për rrjedhojë edhe rënien e ndjeshme të tyre në mësime. Edhe rezultatet e dobta në provimet e

Maturës dhe Minimaturës pa dyshim ju ngarkon me përgjegjësi edhe juve si prind për pjesën që u takon, krahas faktorëve të tjerë.

4. Institucionet eprore të arsimit. Ka vite që këto institucione në nivel qendror, rajonal dhe lokal, bazuar në kompetencat që kanë, si dhenë raportet me njëra-tjetrën sipas pozicioneve ku ndodhennë drejtim të bashkëpunimit, janë mjaftuar vetëm përmes e-maileve dhe rrallë herë për të vajtur në bazë, për të parë konkretisht punën e institucionit që kanë në juridiksion. Sigurisht kjo skemë komunikimi që ka funksionuar prej vitesh midis institucioneve që bëhet fjalë, duke u mjaftuar vetëm me komunikimin nga tavolina përmes e-maileve pa vajtur në bazë, për të parë konkretisht punën e institucioneve që kanë në juridiksion, përbën një stil pune dhe veprimtari të natyrës burokratike. Në këtë drejtim dua të nënvizoj, se edhe kur është bërë ndonjë kontroll në x apo y institucion nga institucioni eprore i tij, ka qenë formal dhe sporadik, sepse nuk është ndjerë përgjegjësi për mangësitë e konstatuara. Kjo ka ndodhur shpesh herë kur janë kontrolluar shkollat tona sipas niveleve nga drejtoritë rajonale arsimore apo MASR-ja ose kur kjo e fundit si institucioni qendror eprore i arsimit, ka ushtruar kontroll ndaj drejtorive rajonale arsimore apo zyrave vëndore të arsimit, si institucione të juridiksionit në raport me MASR-në. Pra e përgjithshme është se kontrollet nuk kanë funksionuar normalisht, e duke funksionuar në këtë mënyrë sigurisht lind pyetja: si ndjehet përgjegjësia e punës në një institucion, pa u ushtruar kontrolli nga institucioni eprore? Si mund të presim rezultate dhe arritje të suksesshme të nxënësve, pa u parë dhe verifikuar konkretisht puna e mësuesve në shkollë? E pra pra kjo që ndodh ndër vite, përbën një paradoks të madh i cili ka ndikuar edhe në rezultatet e dobta të nxënësve në shkollë, nga mungesa e ndjeshme e kontrolleve nga instancat eprore të arsimit.

5. Vetë shteti. Shtetin tonë lidhur me nivelin mjerman të arsimit që tashmë perjetojmë, ku padyshim dhe rezultatet e dobta që përjetohen rradhasi në provimet e Maturës dhe Minimaturës janë rrjedhojë e këtij mjerimi që përjeton sistemi ynë arsimor, do ta vlerësoja si mëkatarin kryesor lidhur me përgjegjësitë që i takojnë. E këtu është fjala për politikën qeverisëse të ndjekura nga shteti gjatë gjithë këtij tranzicioni, për ta mbështetur dhe vlerësuar sektorin e arsimit që ai të bëjë progres dhe zhvillim. Në këtë drejtim të gjithë tashmë jemi dëshmitar se si dhe sa qeverisjet e rradhës në tranzicion, e kanë mbështetur personelin arsimor në drejtimin financiar për punën që bëjnë sipas pozicioneve ku ushtrojnë detyrën e besuar. Indeksi i pagave ka qenë qesharak për shumë punonjës të sektorit të arsimit, veçanërisht për mësuesit që kanë një profesion fisnik, human, madje dhe mjaft delikat, nisur nga misioni që ka. Por shteti ynë, është mëkatar edhe për politikën e ndjekur në drejtim të emrimeve të bëra në pozicionet drejtuese të

sektorit të arsimit. Në këtë drejtim titullarët e arsimit janë bërë me përzgjedhje sipas meritave dhe kontributeve partiake, pa patur parasysh profesionalizmin e tyre, me qëllimin për t'i shërbyer jetëgjatësisë së pushtetit të zyrtarëve të lartë të shtetit dhe atyre që ndodhen në majën e shtetit shqiptar, në sajë të mbështetjes dhe lobimit që sigurojnë në proceset zgjedhore të rradhës nga këta elementë me përzgjedhje militante. Sigurisht një politikë e tillë përbën një tjetër faktor frenues për përparimin dhe zhvillimin e arsimit shqiptar. Pa dyshim të tilla politika të diktuar nga shteti, përbëjnë një paradoks të madh, pasi arsimit është vlerësuar kurdoherë si një nga sektorët prioritar të shoqërisë. Madje arsimit është ai sektor që përgatit gjeneratën e së ardhmes, si dhe kuadrat e të gjitha specialiteteve të nevojshme për një komb dhe një shoqëri të caktuar. Nga vlerësimi i arsimit nga shteti, dalin edhe vlerat e vetështetit me të cilin kemi të bëjmë. Sigurisht për të folur për mëkatet, borxhet dhe vlerësimin që i ka bërë shteti ynë sektorit të arsimit në periudhën e tranzicionit demokratik shqiptar, ka shumë për të thënë, ndaj nuk mund të ezaurohen në një shkrim të vetëm. Lidhur me Provimet e Maturës dhe Minimaturës së këtij viti dua të bëjmë të ditur edhe këto dy tregues të rëndësishëm në vijim:

a) - Testet e hartuara nga ekspertët dhe specialistët, sipas lëndëve të zhvilluara në këto provime, kanë qenë të nivelit mesatar e megjithatë zgjidhja e tyre ka patur ndërlikime dhe vështirësi edhe nga nxënësit e nivelit të 10-ës apo siç nihen me shprehjen: nxënësit ekselentë. Kjo tregon se edhe këta nxënës, kanë patur boshllëqe dhe mangësi në përballje me zgjidhjen testeve të ofruara në provimet e Maturës dhe Minimaturës së këtij viti, pavarësisht se njihen si nxënës të tillë. Gjithashtu dukuria që ndodh me këtë nivel nxënësish, të bën të mendosh se edhe notat 10-ta me të cilat janë vlerësuar këta nxënës nga mësuesit e tyre, janë rrjedhojë e vlerësimeve me taraf e miqësira apo me rrugë të tjera abuzive nga ndërhyrjet e bëra nga individë të caktuar.

b) - Vlerësimet e testeve në provimet e Maturës dhe Minimaturës 2024, nga Komisionet e Vlerësimit të Testeve, ka edhe toleranca me qëllimin që të mos shumë niveli I provimeve që bëhet fjalë nisur rezultatet reale. Por ajo që vlenë për të nënvizuar është se të gjithë aktorët që lartpërmendëm lidhur me kontributet e dhëna për arsimin, përfshirë këtu edhe rezultatet e dobta të Maturës dhe Minimaturës ndër vite, seicili prej tyre (aktorëve), mban peshën dhe përgjegjësinë e tij në sensin negativ, sipas pozicionit ku ndodhen. Në mbyllje dua të nënvizoj se seicili prej aktorëve të lartpërmendur, pa dyshim mban peshën e vet të përgjegjësisë në pozicionin ku ndodhet, dhe jo vetëm për rezultatet e dobta në provimet e Maturës dhe Minimaturës ndër vite, por edhe të arsimit në përgjithësi, nisur nga plagët dhe dhimbjet që përjeton ky sektor në vitet e Tranzicionit demokratik shqiptar, tashmë të tejzgjatur.

k o m e n t e & a n a l i z ë

www.sot.com.al

Shteti ligjor dhe demokracia në Shqipëri

Nga Ali BEQO

Shteti ligjor dhe demokracia në Shqipëri janë tema komplekse dhe aktuale për shqyrtim. Si në shumicën e vendeve të tjera, ka sfida dhe suksese në këto fusha në Shqipëri. Nëse po flasim për shtetin ligjor, është e rëndësishme të vlerësojmë se si funksionon sistemi ligjor në praktikë. Shqipëria ka një kushtetutë dhe një sisteme ligjore të themeluar, por vëzhgime ndërkombe të tilla kanë nënvizuar disa sfida, siç është pavarësia e plotë e sistemit gjyqësor dhe zbatimi i barabartë i ligjit për të gjithë qytetarët. Sa i përket demokracisë, Shqipëria është një vend pluralist me një histori relativisht të re në demokraci pas periudhës së diktaturës



komuniste. Ka pasur zhvillime pozitive si pluralizmi politik, liria e shprehjes dhe liria e mediave, por edhe sfida në aspektet si integriteti zgjedhor dhe transparenca në qeverisje. Opinioni mund të ndryshojë në varësi të perspektivës dhe përvojës personale, por është e rëndësishme të kuptojmë se çështjet e shtetit ligjor dhe demokracisë në Shqipëri kanë nevojë për vazhdimisht përparim dhe përmirësim të proceseve për të siguruar një shoqëri më të drejtë dhe më të qëndrueshme për të gjithë qytetarët. Megjithatë për të kuptuar më gjerësisht gjendjen e shtetit ligjor dhe demokracisë në Shqipëri, mund të shqyrtojmë disa aspekte kryesore:

1. Shteti Ligjor: Koncepti i shtetit ligjor përfshin zbatimin e ligjit dhe pavarësinë e institucioneve gjyqësore. Në Shqipëri, ka pasur sfida të shumta në këtë drejtim. Një prej sfidave kryesore ka qenë pavarësia e sistemit gjyqësor nga ndikimet politike dhe

korruptimi. Një kritikë e vazhdueshme është se vendimet gjyqësore nuk janë gjithmonë të pavarura dhe të drejta. Për të forcuar shtetin ligjor, është e nevojshme që institucionet ligjore të kenë një pavarësi reale dhe të zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët.

2. Demokracia: Shqipëria, pas rënies së regjimit komunist në vitet '90, ka kaluar në një periudhë tranzicioni drejt demokracisë. Në këtë proces, ka pasur përparime të dukshme në pluralizmin politik, lirinë e shprehjes dhe lirinë e mediave. Megjithatë, ka pasur edhe sfida të mëdha, si korruptimi në politikë, ndikimi i grupimeve të interesit në vendimmarrje dhe mungesa e transparencës në qeverisje. Në pjesën e zgjedhjeve dhe procesit zgjedhor, është raportuar për probleme të shumta, duke përfshirë ankesa për bllokimin e opozitës në procesin zgjedhor dhe mosrespektimin e standardit të lirisë

demokratike.

3. Lëvizja drejt përparimit: Në vitet e fundit, Shqipëria ka bërë disa përpjekje për të përmirësuar kritere të rëndësishme për përparimin në rrugën e integritetit evropian. Kjo ka përfshirë reforma në drejtësi dhe institucione të tjera, me qëllim të rritjes së pavarësisë dhe integritetit të tyre. Për të arritur një demokraci funksionale dhe një shtet ligjor të fortë, është e rëndësishme që këto reforma të vazhdojnë dhe të përshejtohen, duke adresuar sfidat dhe mbrojtur liritë dhe të drejtat e qytetarëve.

Përfundimisht, analiza e shtetit ligjor dhe demokracisë në Shqipëri tregon një peizazh me progres por edhe me sfida të mëdha. Është e rëndësishme që qeveria shqiptare dhe shoqëria civile të vazhdojnë të punojnë së bashku për të adresuar problemet dhe për të forcuar institucionet që mbrojnë ligjin dhe liritë demokratike të qytetarëve.

Nga Enver ÇAKAJ

Unë atë kam pasur shtëpinë time. I thoshin Spitali Onkologjik, po ne të sëmurët e quanim drejtorin: "Gjenerali i ushtrisë së vdekur!" Ai ishte spitali i vdekjes. Duhet të jem i vetmi që kam kaluar 27-vjetet në atë spital. Kam patur shumë shokë e shoqe atje, po tani nuk kam asnjë. Madje dhe gjysma e mjekëve kanë vdekur. Nuk kam qenë natyrë qaramane, por vetëm një herë kam qarë në atë spital. Kur mora vesh vjedhurazi diagnozën që më kishin vënë. Kartelat tona kyçeshin hermetikisht, por kishim dhe ne xhigjet tanë që i zbulonim. Unë futa si spiune një sanitare, që më pas u bë infermiere. Çfarë bëra? Ika vetëm nga onkologjiku dhe shkova deri te spitali pesë. Atje e kishim kufirin. Ka qenë fat i organizmit tim që nuk u eliminova me tërë ato mjekime të rënda, që nuk i mbajtën as minjtë. Kimioterapi pa kufi që të merrte mendjen, rreze në të gjitha boshllëqet e trupit! Dhe unë si një mal në këmbë. Drejtoreshë kishim Adelina Mazrrekun, një femër që dinte të merrej me të gjitha moshat dhe tekat tona. Nuk dua të përmend e veçoj njeri tjetër, por atje të gjithë mjekët e infermierët ishin në këmbë në shërbim të sëmurëve. Në atë spital nuk kishte luftë klasash, se diskutohesh për jetën jo për politikën. Në spital ishte shtruar dhe vajza e Liri Belishovës, Drita Çomo. Ishte sa e bukur aq me kulturë. Ajo kishte marrë vesh që unë çoku shkruaja

Kur kujtoj spitalin e vdekjes!

ndonjëherë dhe më erdhi në dhomë. Atë ditë unë kisha bërë ciklin dhe nuk quhesha njeri i kishin thënë se unë isha veteran i onkologjisë dhe më pyeti si kisha rezistuar aq. I shpjegova shkurt dhe ajo iku. Një ditë tjetër erdhi e me sollli ca poezi që i kishte shkruar vetë. Më bëri përshtypje cilësia e tyre dhe i thashë t'i mblidhte në një libër, po kush ishte ajo shtëpi botuese që i pranonte? Pas vdekjes e ëma ja botoi librin, por e kishte politizua me ca sqarime që nuk ishin të vërteta. Unë e takova Lirinë dhe ja shpjegova të gjitha. Atë ditë që u shtrua Drita Çomo, u shtrua dhe një punonjësi i sigurimit të shtetit, i cili qëndroi atje derisa vdiq Drita! Drita rrinte me një shoqe nga Tepelena, që nuk i pengonte askush që të shkonin nga të donin. Por një ditë u ankua një veteran nga Vlora, se përse i shërbeni aq shumë asaj vajze! Në spital nuk kishte dallime në shërbim, por kishte dhe atje ndonjë që në vend të merrej me të sëmurët, gjithë natën e gdhinte në lulishte. Sa e diktoi drejtorja, e pushoi nga puna, se dy punë njëherësh nuk mund të bëheshin. Por më e rënda ndodhi me një mjek, i cili më ndiqte mua. Ai ishte teraqi alkooli dhe lakmonte tek të sëmurët. Kur dola nga spitali formalisht, atë e lash atje, po kur u ktheva nga "pushimet" nuk e gjeta më. Nuk tregonte asnjë se ku kishte vajtur. Si me terezi pyeta një sanitare, po ajo si shikoi nja dy herë

rrotull e mbrapa, më than ë vesh: "Ere çuno, e kanë dnu në prodhim, po mos bxaj se asht i një të madhit!" Në spital unë kisha shok një mjek prej vërteti, që vinte rrinte gjithmonë në dhomën time. Ai ishte sekretar partie për spitalin. Një ditë mua më sollën një shishe raki, po unë nuk pi asnjë lloj pije, as kafe. Kur erdhi shoku im i thashë ta merrte se në spital nuk lejoheshin pijet alkoolike. Ai u ngrit e iku me vrap. Ja dhashë një sanitare t'ja shpinte dhe e porosit nëse nuk e pranonte, ta merrte për vete. Nuk pyeta më se ku qëndroi ajo shishe raki. Juve nuk e besoni, po në onkologji vdisnin çdo ditë, po më shumë qanin mjekët se familjarët! Nuk e kuptoj nga dolën këta xhibiletër që duan të jetojnë me djersën e të vdekurve! Dua të sjell në vëmendje këtu një mjek në klinikën e hematologjisë, që është motra e onkologjisë. Shefi i klinikës quhej Aleko Veshi. Sa qesh unë në atë klinikë, (se unë i kam provuar të gjitha spitalet e Tiranës), nuk e pashë një herë pa lot në sy. Ai u interesua për mua pa më takuar e pa më njohur. Kishte shkuar vetë për të parë biopsinë time, e cila, për shkak se ziheshin të dy mjekët, kishin nxjerrë përfundime të ndryshme. Për këtë shkak, të dy i transferuan njërin në Elbasan e tjetrin në Krujë. Nuk mund të harroj tani mjekun onkolog, Ali Spahia, që më merrte mua përdore dhe më shpinte në të gjitha

laboratorët për analiza. Nuk dua të merrem me ngjarjen e mjekëve të onkologjisë, sepse ata biçimë, vetëm mjekë s'mund të jenë. Mjek tani quhet baba leku. Këtë farë demokracie na sollli ai i kullës së firaunit. Nuk e kuptoj si mund të vazhdosh të veprësh sot, kur kjo është alarmante? Këto ditë shtrova gruan në spitalin e Beratit dhe vajta të takoja mjekun për t'i thënë ndonjë gjë që ajo nuk e dinte. Derën e dhomës e kishte hapur dhe diç shkruante. I kërkova ndjesë që po i ndërprisja punën, po ajo më tha si me inat: "Prit!". Kur unë ngula këmbë se isha duke iku, ajo pranoi të hynim. A e di ky mjek që tek ai paraqiten vetëm njerëz hall-exhinj? U bë si u bë, hyra Brenda dhe I tregova disa veçori të sëmundjes, që ta ndihmoja. Po a e dini si m'u përgjigj: "Këto nuk më interesojnë fare mua!" Mirëpo unë kisha vajtur në spitalin e shtetit dhe brenda sistemit mjekët konsultohen edhe për sëmundje të tjera të sëmurit. Mjeku që nuk njeh mirë të sëmurin s'ka si mjekon sëmundje. Kur ajo pa tre stilolapsa në xhepin e këmbës time, u ngrit dhe shënoi në kartelë me specialistin që i rekomandova. Por një mjek e kushdo specialist që punon me frikë, duhet të largohet sa më shpejt nga ajo punë. Në mëngjes ra zilja e telefonit. Gruaja më lajmëroi se mjeku që do të vijë për konsultë kërkon lek! Atëherë e mora vesh se këta nuk paskan marrë vesh, se ç'ndodhi në Onkologji i thashë gruas që t'i thoshte mjekut të shkojë t'i marrë lekët atje ku i merrnin mjekët e onkologjisë! Njerëzve u qenkan zënë sytë!

Thumanë-Kashar, arteria qendrore e Korridorit Blu

Nga Fatos ÇOÇOLI

Tre ditë më parë u hap për qarkullim aksi i ri rrugor Thumanë-Kashar, autostradë e Kategorisë A të Bashkimit Evropian. Thumanë-Kashar është segmenti i parë i Korridorit Blu, që i paraprin tre kantierëve të reja, segmenteve rrugore Thumanë-Milot, Kashar-Lekaj dhe Lekaj-Fier, të cilat nisin nga puna për disa javë. Po brenda pak javëve rihapet gara për segmentin Milot-Balldren. Shqipëria nuk mund të hyjë në Bashkimin Evropian, pa patur boshte rrugësh cilësore dhe të shpejta, që t'i shërbejnë asaj dhe vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Dy janë boshtet që na shërbejnë si ne, ashtu dhe Bashkimit Evropian, që na do pjesë të tij. Korridorit Blu që vjen nga Veriu dhe përfundon në Jug të vendit, si dhe Korridorit i Tetë, që nis në Durrës dhe përfundon në Qafë Thanë, në kufi me Maqedoninë e Veriut. Korridorit Blu i duhet BE-së, sidomos për shërbimet për turizmin dhe zhvillimin rural të Kroacisë, Bosnje-Hercegovinës, Malit të Zi,

Shqipërisë dhe Greqisë, shteteve nga kalon. Ky Korridor tek ne do të përbëhet nga aksi Milot-Murriqan, aksi Thumanë-Kashar, për të vazhduar në rrugën e sotme moderne që kalon në by-pass-in e Fierit, shkon në by-pass-in e Vlorës dhe zbrit në Jug deri në Greqi. Korridorit Blu tek ne do t'i shërbejë drejtpërdrejt një transformimi të mëtejshëm ekonomik dhe social të vendit. Do ta bëjë Shqipërinë shumë më të aksesueshme nga pikëpamja turistike, përmes tokës, njëlloj si Kroacia, që këtë gjë e ka tashmë prej vitesh. Dhe Kroacia e gëzon këtë, si rezultat i pozicionit të saj, por edhe si rezultat i infrastrukturës rrugore që ka. Ne po vijmë aty, me infrastrukturën rrugore. Aksi Thumanë-Kashar që u përrua më 29 qershor 2024, është rrugë e kategorisë A të standardeve të Bashkimit Evropian. Është një aks me certifikatë sigurie të Bashkimit Evropian. Nuk ka dyqane, kafene, bare, hotele, depo, magazina, makina që pozojnë në dy anë të rrugës, duke krijuar një rrezik të përhershëm. Është një aks shpejtësi, i cili do të jetë një vlerë e shtuar për udhëtimin në zemrën e vendit, por ndihmon shumë edhe lëvizjen nga Rruga e

Kombit, poshtë për në Durrës, apo edhe më tej, për në Vlorë. Thumanë-Kashar lidh Veriun e vendit me Jugun, me shpejtësi deri në 140 km në orë. Autostrada e re do të lehtësojë ndjeshëm trafikun, sidomos në pikun e sezonin turistik të verës, për shkak të fluksit të turistëve që vijnë nga Rinasi. Kjo autostradë përfaqëson zgjidhjen europiane të fluksit të rënduar rrugor që po përjetojmë, për shkak të ngarkimit të rrugëve ekzistuese përreth Aeroportit Ndërkombëtar të Rinasisit, që në katër vitet e fundit ka tërhequr rreth vetës një trafik rrugor tre herë më shumë, në krahasim me vitin 2018. Aksi Thumanë-Kashar i jep frymëmarrjen e shumëpritur të qarkullimit nyjës së Rinasisit, ndërkohë që po gjatë këtij muaji lidhen kontratat për segmentet Kashar - Lekaj - Fier dhe Thumanë - Milot, si edhe hapet gara për segmentet Milot - Balldren dhe Balldren - Murriqan, Të gjitha këto segmente, së bashku me Thumanë-Kasharin që po përfundon, plotësojnë trupin e Korridorit Blu në Shqipëri, si pjesë e unazës europiane të turizmit mesdhetar. Me këtë Korridor mbyllet një pjesë e madhe e rrjetit kryesor

të Shqipërisë, ndërkohë që po punohet fort me zgjerimin e rrugës nga Elbasani në Qafë-Thanë, që Korridorit i 8-të jetë një realitet në pikëpamje të çdo standardi, jo thjeshtë një rrugë e hapur për të kaluar, siç është sot. Kalimi në Thumanë-Kashar, sikurse është vepruar me Rrugën e Kombit, do të jetë me pagesë. Akset kryesore rrugore të çdo vendi, madje edhe shteteve përreth nesh, është normale të jenë me pagesë. Tarifa në Thumanë-Kashar do të varet nga lloji i mjetit, por nuk do të jetë më poshtë se 2.1 euro. Kuptohet që paralel me autostradën e kategorisë A të Bashkimit Evropian, ka edhe zgjidhje alternative, ku kalimi do të jetë pa pagesë për qytetarët. Po për qytetarin apo turistin që zgjedh të fitojë në kohë, një tarifë e arsyeshme për të përdorur këtë aks është mëse normale. Paralelisht me Korridorin Blu, po vijojnë fort financimet për realizimin e Korridorit të VIII-të Durrës - Pogradec, ku do të realizohet edhe lidhja me rrjetin evropian të transportit Lindje - Perëndim, duke përmbyllur boshtet e infrastrukturës rrugore të Shqipërisë 2030, gati për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian.

Dirigjenti Bujar Alliu: Kori interpreton këngë korale të autorëve shqiptarë, si dhe të autorëve botërorë

“International Chamber Choir of Tirana”, përfaqëson Shqipërinë në Festivalin e 6-të Ndërkombëtar të Koreve



Nga Julia VRAPI

Festivali i 6-të Ndërkombëtar i Koreve një prej aktiviteteve të rëndësishme të jetës artistike edhe këtë vit u zhvillua me pjesëmarrjen e disa koreve. “International Chamber Choir of Tirana”, përfaqësoi Shqipërinë në Festivalin e 6-të Ndërkombëtar të Koreve që u zhvillua në Ohër të Maqedonisë së Veriut në datat 26-27 qershor dhe u duartrokoi me këngët- Çelni Lule se erdhi Pranvera (aranzhuar për kor nga Josif Minga), “Amane” (aranzhuar nga Vasil S. Tole), “Libertango” e Astor Piazzolla, etj. “International Chamber Choir of Tirana” zhvillon disa koncerte në vit dhe në vijim të aktivitetit të tij ishte dhe në këtë festival që u zhvillua në Ohër. “International Chamber Choir of Tirana” përgatitet nga drejtori artistik dhe dirigjenti Bujar Alliu, pedagog i dirigjimit Korale pranë Fakultetit të Muzikës të Universitetit të Arteve Tiranë. Drejtori artistik Bujar Alliu tregon se Shqipëria ishte pjesëmarrëse për herë të parë me “International Chamber Choir of Tirana” në këtë festival. “Kori i përbërë nga këngëtarë

nga Shqipëria, Amerika, Austria, Gjermania, Zvicra, Brazili, Holanda dhe Hungaria ka filluar jetën artistike në 2019 në Tiranë, duke interpretuar këngë korale të autorëve shqiptar, si dhe autorë të ndryshëm botërorë, me shtrirje të repertorit sa koral kishtar, po aq dhe korale lirike të kompozitorëve shqiptar. Koncerton dy deri tre herë në vit, duke krijuar një traditë të koncerteve të Krishtlindjes, Koncertit të Pranverës dhe mybilljes së sezonit artistik. Në Ohër në këtë festival merrnin pjesë kore nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Sllovenia, Serbia, etj. Jemi mirëpritur shumë në festivalin në Ohër”, tregon drejtori artistik.

Aktivitetet e Korit

Ky kor që drejtohet me drejtor artistik Bujar Alliu ka marrë pjesë në Festivalin e 27-të Ballkanik të Koreve në qershor të 2022 në Tetovë, dhe pjesëmarrja në Ohër është e dyta pjesëmarrje në një festival ndërkombëtar. Drejtori artistik Bujar Alliu tregon se “International Chamber Choir of Tirana” është një kor i vetëkrijuar me diplomatë që punojnë në Tiranë, ku gjithçka nisi në vitin 2019. “U bënë një

grup nga ata që kanë kënduar nëpër shtetet e tyre në Zvicër, në Hungari, në Austri dhe duke ardhur në Shqipëri me shërbimet e tyre diplomatike krijuan një bërthamë të tillë në 2019, por u përfshinë dhe shqiptarë që punojnë po në institucionet e tyre, por që kanë talentin dhe kanë profesionin për të kënduar. Kjo është e veçanta, sepse ata e vetëfinancojnë, nuk paguan bashkia apo ministria. Është me vullnet të lirë dhe me pasion”, tregon drejtori artistik Bujar Alliu. Por e veçanta e aktivitetit të korit që ka në përbërje të tij pjesëmarrës nga shtete të ndryshme është që ata këndojnë bukur këngët tona në gjuhën shqipe. Repertori muzikor është sa shqiptar aq dhe nga shtete tjera. Drejtor artistik dhe dirigjent Bujar Alliu thotë se tashmë po krijohet një traditë që të zhvillojnë tre koncerte në vit. “Një në pranverë, verë dhe një në fund të vitit për Krishtlindje”, tregon dirigjenti. Koncerti i radhës në “International Chamber Choir of Tirana” do të jetë ai që do hapin sezonin në muajin shtator. Nga aty fillon përgatitja për koncertin e Krishtlindjes.

Kolosi i letrave shqipe Ismail Kadare ndahet nga jeta, dy ditë zi kombëtare

Kolosi i letrave shqipe Ismail Kadare u nda nga jeta mëngjesin e së hënës. Shkrimtari më në zë shqiptar, brenda e jashtë kufijve të Shqipërisë, ishte 88 vjeç. Personalitete të larta të vendit dhe jo vetëm kanë përcjellë mesazhet e ngushëllimit për ndarjen nga jeta të shkrimtarit të madh Ismail Kadare. Akademia e Shkencave të Shqipërisë përmes një mesazhi shpreh se humbi jetën zëdhënësi i një kombi e një rajoni, ndërsa qytetërimin tonë do t'i mungojë shqiptuesi i kumteve të mëdha. “Letërsisë shqipe do t'i mungojë kryemjeshtri, letërsisë europiane do t'i mungojë fizikisht zëdhënësi i një kombi e një rajoni; qytetërimin tonë do t'i mungojë shqiptuesi i kumteve të mëdha. Ismail Kadare është shkrimtari më i rëndësishëm i letërsisë shqipe që prej fillimeve dhe përgjatë pesë shekujve të jetës së saj. Vepra e tij përbën një shtyllë të letërsisë shqipe”, thuhet nga ASHSH. Ismail Kadare u lind në Gjirokastër më 28 janar 1936. Qyteti i lindjes e ndoqi përjetësisht kudo që ai jetoi e shkroi, në Perëndim e në Lindje, duke u bërë pjesë e pandashme e krijimtarisë së tij në të gjitha fazat e jetës. ASH shpreh se me një opus letrar që përmban mbi 70 vepra, në të gjitha llojet e nënlojet e letërsisë, eseistikës dhe publicistikës, të panumërta në botime e ribotime, Ismail Kadare ka zënë e do të ketë kryet e vendit në historinë e letërsisë shqipe. Gjuhë me të cilat ka folur letërsia e tij janë mbi 50 dhe numri i titujve të botuar e ribotuar jashtë gjuhës amtare është mbi 1500. Ndërsa Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës shpreh se përveç si shkrimtar, Ismail Kadare ishte personaliteti qendror i kulturës shqiptare në gjysmën e dytë të shek. XX. “Protagonist i zhvillimeve më të përparuara në letërsinë shqipe gjatë kësaj periudhe”, thuhet nga ASHAK. Ismail Kadare, ndërroi jetë mëngjesin e së hënës si pasojë e një arresti karidak, duke lënë pas një trashëgimi të pasur. Kadare ka qenë disa herë kandidat për çmimin “Nobel” në Letërsi. Ai ka marrë shumë vlerësime, mes tyre dhe dekoratën më të lartë franceze “Officer i Madh i Legjionit të Nderit”. Qeveria ka shpallur dy ditë zi kombëtare të martën dhe të mërkurën për ndarjen nga jeta të shkrimtarit. Homazhet dhe ceremonia shtetërore do të kryhen po të mërkurën në Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit.



Punime restauruese në Teqen e Dollmës në Krujë

Në Teqenë e Dollmës kanë rinisur punimet për restaurimin e saj. Lajmi u bë i ditur nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore. E njohur për vlerat e saj arkitekturore, dekorative dhe tipologjike, Teqesë iu dëmtuan muret dhe kupola e saj nga tërmeti i 26 nëntorit 2019. Në vitin 2020 u kryen punime emergjente konsolidimi për të reduktuar në afat të shkurtër rrezikun e kolapsit total. Në vitin 2021,

CHwB Albania nisi zbatimin e projektit për konservimin dhe restaurimin e këtij objekti. Teqeja e Dollmës në Krujë monument kulture kategoria e parë është një pikë referimi e rëndësishme për komunitetin lokal të qytetit historik të Krujës, si dhe një pasuri e rëndësishme për komunitetin fetar bektashi në zonë. Në gjininë e faltoreve islamike ajo përfshihet në tipin e vogël monumental me kupolë.

IKTK dhe DRTK Gjirokastër inspektim në Teqenë e Koshtanit

Në kuadër të punës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Gjirokastër, u realizua inspektimi i radhës në “Teqenë e Koshtanit”, në fshatin Koshtan, Bashkia Memaliaj, me qëllim hartimin e një projekti të plotë restaurimi për këtë pasuri kulturore. “Teqeja e Koshtanit është një objekt kulti, Monument Kulture i Kategorisë së parë (I), datë 4.9.2006. Kjo

faltore është themeluar nga Baba Muharremi në fillim të shekullit 20-të. Teqeja është një ndërtim me mur guri 2 katësh mbuluar me çati me rrasa guri, me një shtrirje planimetrie në formën “T”. Në vitin 2009 i është bashkëngjitur edhe ballkoni i hyrjes me shkallë guri të jashtme”, thuhet nga IKTK. Inspektimi u përqendrua në verifikimin e gjendjes së konservimit të strukturës, elementëve arkitektonikë dhe dekorativë në tërësi.

Nesër në Vilën Mbretërore në Durrës do të flitet për artin dhe arkitekturën

Të mërkurën në Vilën Mbretërore të Durrësit do të flitet për artin dhe arkitekturën. Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës shpreh se në aktivitetin përmblyës të semestrit të dytë do të jetë një takim në kuadër të serisë HARTALK, ku do të flitet për artin, arkitekturën dhe hapësirat e bukura shqiptare. “Ky takim do të nisë me një bisedë me arkitektët e mirënjohur Gëzim Paçari-

zi, Alban Birce, Matilda Pando, si dhe autorët e librit “Fragmente të Arkitekturës Bashkëkohore shqiptare” Armand Vokshi, Blerta Vula Rizvanolli dhe Nesila Hajdini ku do të shtjellohen konceptet dhe relacionet e arkitekturës me ujin. Më pas do të mund të vazhdojmë vizitën në këtë vilë të rëndësishme të arkitekturës në vendin tonë, përmes instalacionit artistik nga Stefano Romano”, thuhet nga FAU.

■ Për fondin për teatrin konkurrues 27 projekte

Shpallen 11 projekte fituese të “Fondi i Teatrit për të Rinj”, artistët kanë propozuar pjesë të dramaturgjisë shqiptare dhe asaj të huaj

Nga Julia VRAPI

Pjesë të dramaturgjisë shqiptare si dhe asaj të huaj do të vijnë në skenën teatrore përmes projekteve fituese të “Fondit të Teatrit për të Rinj”. Fondi për vitin 2024 do të shpërndahet për 11 projekte fituese, që u bënë me dije nga Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” një ditë më parë. Teatri shprehet se “Fondi i Teatrit për të Rinj” nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit është në përputhje me misionin dhe politikën mbi nxitjen, promovimin dhe krijimin e hapësirave mbështetëse për skenën e pavarur artistike, e veçanërisht në fushën e teatrit. “Përmes një fondi prej 12 milionë lekësh, ne synojmë të nxisim dhe të zgjerojmë hartën kulturore, duke e shtrirë gjeografikisht këtë fond; duke krijuar lëvizjen teatrore në bazë të rajoneve nga jugu në veri, në një formë bashkëprodhimi me teatrot e rretheve; duke ofruar mundësinë që teatri si zë i së vërtetës po shkon në të gjithë hartën tonë; duke aktivizuar krijuesit dhe interpretuesit e rinj dhe adresuar ata të punojnë dhe sigurojnë mbarëvajtjen jo vetëm në infrastrukturën e teatrit në Tiranë, por edhe në rrethe”, thuhet nga teatri. Projektet përfituese nga ky fond do të realizohen nën kujdesin e Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, ndërsa teatrot e rretheve do të mbështesin projektet e këtij fondi, përmes logjistikës teatrore.

27 propozime te fondi për teatrin për të rinj

Në këtë fond ka pasur një numër të lartë propozimesh, ku kanë qenë plot 27 të tilla, prej të cilave janë zgjedhur nga bordi



artistik i TKEKS 11 projekte fituese, ku 1 është regjisore vajzë dhe 10 regjisorë djem. “Një pikë tjetër e rëndësishme në këtë thirrje ka qenë edhe promovimi dhe vënia në skenë e dramaturgjisë shqiptare përveç asaj të huaj, për të mos ngritur dorën tek regjisorët, pse nuk zgjedhin dramaturgjinë tonë”, shprehet teatri. Prej 11 projekteve që do të vihen në skenë, artistët e rinj kanë propozuar 3 pjesë të dramaturgjisë shqiptare dhe 5 të dramaturgjisë së huaj dhe 1 dance kontemporan. Shpërndarja gjeografike e projekteve është: Tiranë- 3 projekte; Korçë- 2 projekte; Vlorë- 1 projekt; Shkodër- 2 projekte; Gjirokastër- 1 projekt; Berat- 1 projekt; Bulqizë - 1 projekt. Ashtu si dhe vitet e tjera, në përfundim të punës për të gjitha veprat, do të organizohet një javë e dedikuar festivalit të teatrit për të rinj që sërish do të jetë nën titullin “HAPAT”, në skenën e Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli” dhe në sallën Black Box të Universitetit të

Arteve, duke e finalizuar me ndarjen e çmimeve për të gjitha kategoritë pjesëmarrëse, nga një juri profesioniste. Fituesit e “Fondit të teatrit për të rinj” janë: Anxhelo Dauti - vepra “Striptizë në det të hapur”, autori Jon Fosse, në Korçë; Refael Hoxhaj - vepra “Hanë gjaku”, autori Ernest Koliqi, në Shkodër; Xhuliano Briskaj-vepra “Dikush do kujdeset për mua”, autori Franc MC.Guinness; Renis Hyka- vepra “Samara”, autori Renis Hyka, në Tiranë; Mariel Brahimllari-vepra “Terezitje”, danc kontemporan, në Korçë; Gert Palali - vepra “Një kg shegë”, autor Sued Arilla, në Shkodër; Artemis Beluli- vepra “Importum”, autor Tad Mosel, në Gjirokastër; Xhino Musollari- vepra “Marmelladov”, autor Fyodor Dostojevski, në Tiranë; Lindar Kaja -vepra “Le horla”, autor Guy de Maupaassant, në Bulqizë; Ermir Hoxhaj-vepra “Një natë në Nëntor”, autor Marie Jones, në Vlorë si dhe Marsel Greva- vepra “Në lindje të Berlinit”, autor Hannah Moscovitch, në Berat.

Mbrëmja poetike “Çdo unazë më del nga gishtat”

Mbrëmja poetike “Çdo unazë më del nga gishtat” erdhi me krijimtarinë të autoreve gra e vajza të trojeve shqiptare. Qendra për Hapje dhe Dialog shprehet se ajo erdhi me aq muzikalitet si ndërthurje e interpretimit të aktorëve të mirënjohur Ndriçim Xhepa dhe Kristaq Skrami, shoqëruar nën tingujt e kompozitorit Aulon Naçi në piano. “Poezia ka një aftësi unike për të nxitur emocionet tona, për të sfiduar perceptimet dhe për të na sjellë më pranë njëri-tjetrit. Publiku artdashës u zhyt në një botë ku gjuha shqipe kërceu në skajin e imagjinatës me pjesë nga krijimtaria

e: Natasha Lako, Rita Petro, Flutura Aça, Luljeta Lleshanaku, Ledia Dushi, Mimoza Ahmeti, por edhe Flora Brovima nga Kosova, Lindita Ahmeti nga Maqedonia e Veriut, e Lumnije Hoxha nga Mali i Zi, etj”, thuhet nga Qendra për Hapje dhe Dialog

për këtë mbrëmje që u zhvillua në hapësirat e saj më 27 qershor në bashkëpunim me artisten Rozeta Feri. Kjo mbrëmje që u zhvillua në COD vjen në vijim dhe të tjerë aktiviteteve që janë zhvilluar gjatë kësaj kohe, e mes tyre nuk kanë munguar dhe ato që i janë kushtuar librit dhe krijimtarisë së autoreve të ndryshëm. Qendra për Hapje dhe Dialog- COD pranë kryeministrisë u hap për herë të parë për publikun në korrik të vitit 2015. Qendra për Hapje dhe Dialog- COD ka disa hapësira dhe secila prej tyre funksionon në bazë të një kalendari, ku zhvillohen ekspozita, prezantime librash, bashkëbisedime dhe ceremoni protokollare, projeksione filmash, forume diskutimesh, etj.



“Teoria e restaurimit” prezantohet në Institutin Italian të Kulturës

■ Në mjediset e Institutit Italian të Kulturës, u realizua prezantimi i botimit shqip të librit “Teoria e Restaurimit” i Cesare Brandi, shqipëruar nga dr. Daniela Kavaja dhe dr. Lllazar Kumaraku, tashmë pjesë e publikimeve shkencore të universitetit Polis. Me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, ekspertëve të fushës, profesorë e stu-

dentë, u diskutua së bashku me autorët rreth botimit dhe të ftuarit ndanë opinionet e tyre profesionale rreth rëndësisë së tij në fushën e restaurimit, i cili ka shërbyer si bazë në teorinë dhe praktikën e konservimit dhe restaurimit në mbarë botën. Botuar për herë të parë në 1963, ky botim mbetet një tekst i rëndësishëm në fushën e mbrojtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore.

Saviana Vjerdha fitoi dy çmime në festivalin “Zambaku i Prizrenit”

■ Këngëtarja e teatrit “Migjeni” të Shkodrës, Saviana Vjerdha u shpall fituese e dy çmimeve në festivalin e këngës qytetare “Zambaku i Prizrenit”. Këngëtarja Vjerdha fitoi çmimet “Këngëtarja më e mirë” dhe “Çmimi Zambaku i Prizrenit”, me këngën, “Kangë rruge”. Kompozitor Tonin Tarnaku; teksti Azem Shkreli; orkesttrimi Shpëtim Saraçi. Festivali i këngës “Zambaku i Priz-

renit” është themeluar në vitin 1986 nga institucionet e atëhershme kulturore të Kosovës, si ngjarje e vetme kulturore që kultivon zhanrin e muzikës qytetare. Ky festival është dhe një nga ngjarjet më të rëndësishme artistike dhe kulturore në Prizren. Festivali “Zambaku i Prizrenit 2024” më herët hapi konkursin për këngët pjesëmarrëse në edicionin e 35-të këtë vit.

Filmi i restauruar “Gjeneral Gramafoni” shfaqet në festivalin në Konisë

■ Filmi i restauruar “Gjeneral Gramafoni” me regji nga Viktor Gjika realizuar në 1978 u shfaq në Festivalin e Muzikës së Ballkanit Jugor, i titulluar “Why the Mountains are Black”, i cili u zhvillua në Konicë, Greqi nga data 28 - 30 qershor. Ky festival, i kuruar nga Christopher King, etnomuzikolog, shkrimtar, producent dhe mbështetës i muzikës folklorike, paraqiti mes të tjerash edhe

performancën polifonike të Grupit Lab, krahas shfaqjes së filmit shqiptar “Gjeneral Gramafoni”. Më parë sipas njoftimit të Arkivit të Filmit aktivitetet artistike mbaheshin në Shtëpinë e Hamkos, që është shtëpia e muze, monument kulture, e nënës së Ali Pashë Tepelenës. Filmi i restauruar “Gjeneral Gramafoni” është shfaqur dhe në të tjera aktivitete në vendin tonë.

Xhaka është lideri i vërtetë i Zvicrës, kush nuk e kupton këtë s'është trajner

Gazetari i njohur zviceran, Marcel Reif, dha një deklaratë për Granit Xhakën, kapitenin e Zvicrës. Reif punon si gazetar e komentator që nga viti 1972, ndërsa ka folur në një emision televiziv në Zvicër pas kualifikimit të helvetikëve në çerekfinale të Evropianit. Ndër të tjera është pyetur për përplasjet e mëhershme të Xhakës me selektorin Murat Jakin. Gazetari zviceran ka thënë se me Jakinin nuk është lehtë të punohet, por se ai ka kuptuar që gjërat funksionojnë vetën nëse bëhen së bashku. "Nëse keni një lojtar si Xhaka dhe nuk i shfrytëzoni kualitetet e tij, për inat, për fyerje apo për çfarëdo

tjetër, atëherë ju jeni një idiot dhe ju jeni në pozitën e gabuar", tha Reif. "Disa gjëra duhet të zgjidhen si të rritur dhe këta dy e kanë bërë këtë. Është sjellje shembullore", tha Reif. Xhaka e Jakini vazhdimisht e përsërisin se i kanë raportet shembullore. Por përplasja e tyre e dikurshme vazhdon të jetë temë. Madje në Zvicër i japin të drejtë kapitenit e jo trajnerit, diçka që nuk mendohej më parë dhe në asnjë vend evropian, por Xhaka është personalitet i grupit. Padyshim falë kësaj performace, Xhaka dhe lojtarët zviceranë mund shkojnë larg në këtë evropian. Pasi tifozeve zviceranë iu desh të prisnin 31 vjet për

fitoren ndaj Italisë në 1/8-at e Evropianit, në rastin e Anglisë pritja është tashmë 43-vjeçare. Në maj të vitit 1981, kombëtarja helvete festoi për herë të fundit suksesin ndaj rivalëve anglezë, 2-1 në kualifikueset e Botërorit para 40 mijë tifozëve në Jogeli. Zvicra dhe Anglia u takuan për herë të fundit në një ndeshje zyrtare në vitin 2019. Në ndeshjen për vendin e tretë në Ligën e Kombeve, ata humbën ngushtë pas goditjes së penalltive. Për Granit Xhakën fjalët më të mira s'i kurseu as mediumi "The Guardian". "Granit Xhaka është vetëm tri ndeshje larg që të jetë një nga kandidatët më serioz për "Topin e Artë".



Asani, Broja, Strakosha e të tjerë ndodhen në fokusin e shumë klubeve elitare europiane

Deputeti gjerman i mahnitur nga ecuria e Shqipërisë në Euro-2024, kuqezinjtë në vitrinën e merkatos në Europë

Adriatik BALLA

Një pjesë e mirë e lojtarëve të Kombëtares kuqezi kanë rënë në "radarët" e klubeve të njohura europiane, pasi paraqitja e tyre në Evropianin e Gjermanisë ishte shumë e mirë. Duhet thënë se disa lojtarë spikatën në këtë Evropian dhe kanë marrë vëmendje direkte. I tillë është portieri Thomas Strakosha që mund të ndryshojë ambient në edicionin e ri. Ai mund të braktisë Brentfordin anglez për një klub të Serisë A, ose brenda Anglisë në një klub tjetër ku të ketë mundësinë të luajë titullar. Kurse mbrojtësi Mario Mitaj ka vëmendjen e Lacios dhe të disa klubeve elitare italiane. Paraqitja e Mitajt në Evropian ishte shumë e mirë dhe shqiptari me siguri që do të largohet nga Moskë në sezonin e ri dhe do të bëhet pjesë e një klubi të rëndësishëm në perëndim.

Broja dhe Asani, më të kërkuarit

Duhet thënë se Armando Broja vijon të jetë në pronësi të Çelsit, por i huazuar tek Fulhami në sezonin që lamë pas. Broja mund të mbetet te Çelsi, por edhe mund të huazohet sërish. Gjithsesi, ai ka marrë vëmendje të shtuar nga disa klube të Serisë A, përfshi gjigantët e Milanit. Në Itali ka



Qëndrimi i deputetit gjerman Bejer

dhe klube të tjera që kanë shfaqur interes për Brojën, ku në mediat italiane është lakuar Xhenoa. Por edhe në Premier League e duan futbollistin. Mbetet të shihet çfarë vendimi do të marrë Çelsi për sulmuesin shqiptar. Sa i takon sulmuesit të krahut, Jasir Asani, ai është pjesë e Guangju në Korenë e Jugut dhe nuk e ka gjetur prej gati një viti gjuhën me klubin për një shkëputje me mirëkuptim. Për Asanin interesohet Las Palmas, që është gati të paguajë për ta bërë të vetin. Lojtari po negocion me klubin e tij korean për të lënë Azinë dhe për të kaluar në Europë, konkretisht në La Liga spanjolle, me Las Palmas. Marrëveshja mes klubit spanjoll dhe lojtarit në parim është arritur.

Paraqitja e kuqezinjtë nuk ka kaluar pa rënë në sy edhe të shumë figurave publike në Gjermani. Kjo pasi tifozeria shqiptare e shndërroi Evropianin e Gjermanisë në festë masive. Deputeti i Bundestagut, Peter Bejer, e ka vlerësuar lart paraqitjen e Kombëtares Shqiptare në Euro 2024. Deputeti i CDU-së ka thënë se paraqitja e djelmohave shqiptarë duhet të jetë frymëzim për gjeneratat e ardhshme. "Urime kombëtares shqiptare për paraqitjen mbresëlënëse në UEFA Euro 2024! Vendsmëria, puna e palodhur dhe shpirti i tyre ekipor kanë frymëzuar jo vetëm Shqipërinë por edhe tifozët e futbollit në

"Më parë edhe vetë policia gjermane e ka cilësuar sjelljen e shqiptarëve në këtë Evropian perfekte. Shqiptarët pushtuan këtë verë rrugët dhe impiantet e Gjermanisë, duke u dhënë tifozerive të tjera pjesëmarrëse në Gjermani-2024 leksione sjelljeje e prezantimi..."

mbarë botën. Një falënderim i veçantë shkon për trajnerin Sylvinho dhe gjithë ekipin për punën e tyre të jashtëzakonshme. Jam i bindur se kjo arritje madhështore do të jetë frymëzim për brezat e ardhshme. Forca Shqipëri" shkruan Beyer. Nuk është i vetmi, pasi më parë edhe vetë policia gjermane e ka cilësuar sjelljen e shqiptarëve në këtë Evropian të nivelit më të lartë, pra perfekte. Shqiptarët pushtuan këtë verë rrugët dhe impiantet e Gjermanisë, duke u dhënë tifozerive të tjera pjesëmarrëse në Gjermani-2024 leksione sjelljeje e prezantimi. Ata ishin të zhurmsëm por Brenda kontureve të tifozerisë. Një sjellje spektakolare që është komentuar gjatë në Evropianin e Gjermanisë.

Lëvizja/ Partizani përforcohet me Agim Zekën nga Kosova

Në Kategorinë Superiore klubet kanë nisur lëvizjet e tyre, me shpresën se do t'i bëjnë përfundimet e duhura ende pa nisur ndeshjet në kompeticionet e UEFA-s. Tirana dhe Partizani i kanë nisur në fundjavë lëvizjet e tyre dhe pritet të bëjnë përfundime për paraqitjen që do të bëjnë në Ligën e Konferencës. Kështu, Partizani përforcon radhët në repartin ofensiv, duke

njoftuar në faqen zyrtare akordin me Agim Zekën. Sulmuesi, sezonin e fundit ishte pjesë e Erzenit ndërsa më herët në karrierën e tij është aktivizuar edhe me Skënderbeu. Lojtari nga Prishtina është vendosur menjëherë nën urdhrat e trajnerit Orges Shehi në Pogradec për të kryer fazën përgatitore. "Partizani me kënaqësi njofton se ka arritur marrëveshjen për

afrimin e futbollistit Agim Zeka. Sulmuesi nga Prishtina i bashkohet të kuqeve pas një sezoni pozitiv te Erzeni, skuadër me të cilën realizoi 5 gola dhe dhuroj 4 asiste. 25 vjeçari ka nënshkruar një kontratë 2 vjeçare me opsion rinovimi edhe për një tjetër sezon. Zeka menjëherë është vënë nën urdhrat e trajnerit Orges Shehi teksa i është bashkuar skuadrës në qytetin



e Pogradecit. Mirësevjen në familjen e Kuqe Agim Zeka!", shkruan klubi.

KOSOVË

Llapi përforcohet me Lulzim Pecin

Llapi ka bërë përfundim të rëndësishëm për edicionin e ardhshëm garues. Llapjanët e kanë prezantuar të hënën mesfushorin mitrovicase, Lulzim Peci. 22-vjeçari ishte pjesë e rëndësishme e Kosovës U21, ndërsa deri më tani ka luajtur për Trepçën '89. Te skuadra mitrovicase ishte bartës i lojës. Shquhet për stabilitetin dhe vizionin për lojën. Peci ka vendosur për hapin tjetër në karrierë, përkatësisht për t'u sprovuar në Superligë. Ai pritet të jetë i rëndësishëm për ekipin e Tahir Batatinës.

TRANSFERIMI

Kuçi lë Ballkanin, i bashkohet Neftçit në Azerbajxhan

Ish-kapiteni i Ballkanit, Edvin Kuçi, i është bashkuar skuadrës elitare të Azerbajxhanit, Neftçi. Lajmi është bërë i ditur nga klubi i tij i ri në rrjetet sociale. Kuçi ka nënshkruar kontratë trevjeçare. 30-vjeçari ishte pjesë e Ballkanit për katër vjet. Ai ishte transferuar te suharekasit nga Gjilani në vitin 2020. Me Ballkanin i fitoi gjitha trofetë në Kosovë, ndërsa ishte pjesë e suksesit historik të Ballkanit në grupet e Ligës së Konferencës. Kuç luan për përfaqësuesen e Malit të Zi.

LËVIZJA

Ballkani i Dajës merr Ismajlgecin për duelet në Champions

Ballkani vazhdon të përforcojë ekipin për sezonin e ardhshëm duke u fokusuar me shumë te mbrojtja. Klubi nga Suhareka ka bërë të ditur se ka arritur marrëveshjen me Marsel Ismajlgecin. Ish-mbrojtësi i Tiranës ishte në huazim nga Zrinjski te Ballkani, teksa tashmë është zyrtarizuar blerja e përhershme e lojtarit. Ismajlgeci bashkohet përfundimisht me Ballkanin, me të cilët firmos kontratë deri në vitin 2027. Kujtojmë se kjo është dhurata e dytë në mbrojtje për Ilir Dajën, pas Smajlit.

Birçe përcillet në banesën e fundit, FSHF e vlerëson për kontributet

Komuniteti i futbollit shqiptar ka përcjellë dje për në banesën e fundit legjendën Bejkush Birçe, ish-futbollisti i madh dhe ish-trajneri i Kombëtares, i cili u nda nga jeta dy ditë më parë në moshën 87-vjeçare. Në homazhet e organizuara sot nën kujdesin e FSHF-së në stadiumin "Air Albania" morën pjesë edhe Sekretari i Përgjithshëm i FSHF-së, Ilir Shulku, Zv. Presidentët e FSHF, Arben Dervishaj e Lutfi Nuri, anëtarët e KE-së së FSHF, Anila Basha e Abdyl Kuriu si edhe zyrtarë të tjerë të FSHF. Pasi vendosën kurora me lule dhe u përlulën me respekt para arkivolit, duke u shprehur ngushël-

limet familjarëve të Bejkush Birçes, Sekretari i Përgjithshëm i FSHF-së, Ilir Shulku tha në një prononcim për median se futbollit shqiptar humbi një ikonë dhe një bashkëpunëtor që të gjithë jetën e tij ia përkushtoi futbollit. "Sot është një ditë e dhimbshme për futbollin shqiptar, pasi ka humbur një nga ikonat dhe kollosët e futbollit. Një trajner, edukator, prind, bashkëpunëtor dhe mik i devotshëm që të gjithë jetën e tij ia përkushtoi futbollit me seriozitetin e tejskajshëm që ai kishte për futbollin. Virtyt që besoj do t'ja lëri shumë brezave të mëvonshëm dhe do ta kujtojmë me nostalgji. Një veti që ka pasur

profesor Bejkushi ka qenë serioziteti në punën e tij, siç e thashë ka qenë një bashkëpunëtor mjaft i mirë dhe në punën e tij është karakterizuar nga serioziteti i tejskajshëm. Për mua por besoj edhe për të gjithë opinionin sportiv ka qenë një nga njerëzit më serioz në punë, i paharruar qoftë kujtimi i tij!", tha Sekretari i Përgjithshëm i FSHF-së Ilir Shulku. Kujtojmë që në homazhet për Birçen, bërë dje nga ambientet e "Air Albania", pati një numër të madh personalitetesh, që vlerësuan lart kontributet e tij të mëdha në sportin shqiptar, veçmas në futbollin e Partizanit dhe të skuadrës kombëtare.



Gripshi u prezantua te Astana në Kazakistan, Rahmanin e do Bolonja, Dede ikën nga Elbasani

Merkato sjell lëvizje për disa lojtarë shqiptarë, priten surpriza ditët në vijim

Adriatik BALLA

Kur është mbyllur një muaj nga zhvillimi i merkatos verore ka befasi në shumë lëvizje që kanë ndodhur. Vëmendjen e kanë marrë kryesisht lojtarët që shkojnë jashtë, në klube elitare, ndërkohë që ka edhe lëvizje në pankina të ndryshme në Superiore ende pa nisur sezoni i ri.

Albion Rahmanin kërkohet me ngulm nga Bolonja

Bolonja ishte padyshim surpriza më e bukur e këtij sezoni në Serie A, me "Kuqebllutë", që siguruan me meritë një biletë në grupet e Champions League për sezonin e ardhshëm, mirëpo duket se ky grup i mrekullueshëm që është krijuar te kjo skuadër do të shkrihet gjatë merkato së verës. Tekniku italo-brazilian, Thiago Mota, do të largohet drejt Juventus, ndërkohë që me valixhe gati është edhe Joshua Zirkzee, "ylli" i skuadrës, me "tulipanin" holandez, që pëlqehet shumë nga "Zonja e Vjetër", por edhe "Djajtë" e Milan, teksa nuk përjashtohen as kalimi në Premier League apo rikthimi te Bayern. Për këtë arsye, drejtuesit e Bolonjës kanë nisur nga puna për të gjetur zëvendësuesin e tij dhe në listën e dëshirave është edhe një shqiptar. Bëhet fjalë për



Albion Rahmanin, sulmuesin e përfaqësueses së Kosovës, pjesë e Rapid Bukureshtit në Rumani. "Dardani" ka realizuar plot 19 gola këtë sezon me ekipin kryeqytetas me 23-vjeçarin nga Podujeva, teksa numëron edhe 5 asistime dhe falë këtyre performancave pozitive ka tërhequr vëmendjen e klubeve të ndryshme. Benfika e monitoron prej kohësh, gjithashtu edhe Verder Bremen, por jo vetëm, pasi Rahmanin pëlqehet shumë edhe nga Bolonja dhe sipas shtypit italian raporton se dyshja Sartori-DiVaio po ndjekin me interes goleadorin e talentuar, për të cilin Bolonja do të ishte një destinacion perfekt.

Gripshi prezantohet tek Astana në Kazakistan

Klubi i futbollit nga Kazakistan, "Astana" ka zyrtari-

zuar transferimin e mesfushorit shqiptar Nazmi Gripshi. Futbollisti 26-vjeçar e kaloi pjesën më të madhe të karrierës së tij te skuadra e Ballkanit te Suharekes, ku Astana me te u takua në Ligën e Konferencave të UEFA-s në sezonin 2023/24. Ai luan si mesfushor sulmues dhe mund të luajë si anësor i majtë ose i djathtë. Nazmi ka shënuar 31 gola dhe ka dhënë 25 asistime për skuadrën e Kosovës. Te Skenderbeu shënoi 14 gola dhe 14 asistime. Klubi dhe futbollisti janë dakorduar për një kontratë 2-vjeçare.

Nevil Dede nuk është më trajneri i Elbasanit

Ndërkohë, nuk ka vetëm lëvizje lojtarësh, por edhe trajnerësh, madje ende pa nisur sezoni i ri. Kështu, skuadra e AF Elbasanit, që sezonin e kaluar siguroi

"Nuk ka vetëm lëvizje lojtarësh, por edhe trajnerësh, madje ende pa nisur sezoni i ri. Kështu, skuadra e AF Elbasanit, që sezonin e kaluar siguroi biletën e rikthimit në Superiore, ka njoftuar këtë të hënë se klubi dhe trajneri kanë mbyllur bashkëpunimin..."

biletën e rikthimit në Superiore, ka njoftuar këtë të hënë përmes një postimi në rrjetet sociale se klubi dhe trajneri kanë mbyllur bashkëpunimin. "Njoftim! AF Elbasani dëshiron të njoftojë të gjithë opinionin futbolldashës në Elbasan për ndërprerjen e bashkëpunimit mes klubit dhe trajnerit Nevil Dede. Politikata dhe strategjia e klubit nuk u gjenden në vija të përbashkëta kooperimi me trajnerin dhe për rrjedhojë të dyja palët dakorduan ndërprerjen e kontratës së përbashkët. AF Elbasani i përcjell falenderimet më të sinqerta trajnerit për të gjithë kontributin e dhënë sezonin e shkuar si trajner i skuadrës në përmbushjen e objektivave dhe i uron suksese të mëtejshme në karrierën e tij!"-shkruhet në reagimin e AF Elbasanit.

QËNDRIM

Duka: Me Silvinjon diskutojmë javën e ardhshme

Kreru i FSHF-së, Armand Duka, theksoi në një emission televiziv në Kosovë se ai dhe trajneri i Kombëtares Silvinjo do të diskutojnë për kontratën javën e ardhshme, pasi tekniku brazilian të kthehet nga pushimet. "E kam thënë, Silvinjos i ka mbaruar kontrata pas Europanit, por ne jemi në mirëkuptim për ta vazhduar atë, pavarësisht se nuk është hedhur firma. Ka shkuar të pushojë disa ditë dhe javën tjetër do të takohemi sërish për të diskutuar këtë temë dhe për të vazhduar punën.

SKANDALI

Dukagjini përjashton nga ekipi 12 futbollistë njëherësh

Në Kosovë, krahas rritjes së cilësisë futbollistike, ka dhe lëvizje që shkaktojnë çudira në mes tifozëve e në media. Klubi futbollistik, Dukagjini, ka njoftuar se me marrëveshje të dyanshme ka ndarë rrugët me 12 futbollistë. Ata janë: Kenan Haxhihamza, Ardin Dallku, Blerind Morina, Bujar Shabani, Redon Sylja, Gëntrit Salihu, Iran Junior, Dren Feka, Osman Mëziu, Amsal Krasniqi, Paulo Victor dhe Pascal Chidi Bolu. Klubi i falënderon të gjithë për kontributin e dhënë për ekipin.

SUPERIORE

Dinamos do t'i bashkohet një brazilian për pak ditë

Dinamo ka ambicie të jetë një protagonist për titull në sezonin e ri në Superiore. Ndërkohë, sa i takon merkatos së verës, Denison është larguar pas dy sezonesh e gjysmë nga blutë, por brazilianët e kësaj skuadre me shumë mundësi do të jenë sërish dy. Përveç Lorranit, një tjetër mbrojtës brazilian pritet që jetë pjesë e kryeqytetasve, pasi klubi ka arritur ka arritur një akord me të. Bëhet fjalë për një mbrojtës qendër me eksperiencë, që mund të bashkohet me Dinamon rreth datës 10 korrik.

Deklarata/ Behrami: Kjo Zvicër është më e mira në histori

Europiani i Gjermanisë po vijon të japë emocione dhe spektakël, edhe pse, me përjashtim të Italisë që u eliminua nga Zvicra, nuk ka ende largime të rëndësishme. Ndërkohë, në Zvicër ka eufori pas kualifikimit në çerekfinale të Kampionatit Evropian. Për këtë ka shkruar edhe Valon Behrami, ish-reprezentuesi i Zvicrës, në kolumnen e rregullt për "20 Minuten". "Këto janë momente që i bashkojnë njerëzit, pavarësisht nëse e duan futbollin apo jo. Për këtë do të flasim në dekadat që vijnë.

Është më shumë se vetëm kualifikim në çerekfinale", ka shkruar Behrami. Sipas tij, Zvicra ka dominuar plotësisht ndaj Italisë. "I kemi treguar Evropës se kush jemi. Jam krenar me këtë ekip nacional", ka vazhduar ish-mesfushori luftarak. Behrami ka luajtur gjatë për Zvicrën, por ekipin aktual e vlerëson më të mirin të helvetikëve. "Ky ekip nacional është më i madhi që vendi ka pasur ndonjëherë. Është gjeneratë e artë. Të ëndërrojmë lejohet dhe ndeshjet si ajo e së shtunës në Berlin dëshmojnë që me këtë mentalitet dhe



me këtë paraqitje, ëndrrat po bëhen realitet. Le të shijojmë këto ditë", ka shkruar Behrami në artikullin e tij. Vetë ai ka qenë pjesë e rëndësishme e Zvicrës vite më parë.

kulturë

Një grup i ish punonjësve padisin reperin Kanye West

Kanye West është paditur nga një grup i ish-punonjësve të tij. Ky grup po e akuzon Westin dhe ish-shefit e stafit, Milo Yiannopoulos, për "ambient racist", duke i detyruar të punonin në orar jashtëzakonisht të gjatë, shkruan TMZ. Ky grup punonjësish ishin punësuar të punonin në aplikacionin e West, i cili do të lançonte shërbime transmetimi, të cilin ai dëshiron-

te ta përdorte për promovimin e dy albumeve të tij "Vultures" dhe "Vultures 2". Këtyre punonjësve, West, u kishte premtuar paga prej 120 mijë dollarësh nëse do ta kompletonte aplikacionin. Sidoqoftë, ata pretendojnë se West më vonë i kishte detyruar të nënshkruajnë një lloj marrëveshjeje, kushtet e të cilës nuk janë bërë publike, nën kërcënimin se do ta humbasin

punën dhe nuk do të paguheshin. Ndërkohë, disa prej punonjësve, të cilët ishin minorene, këngëtarë i ka detyruar të nënshkruajnë kontratën si "vullnetarë". Punonjësit, të cilët punonin online, kur pyetën për pagën e tyre nuk morën përgjigje nga West, e as nga Yiannopoulos, gjë që i detyroi t'i padisnin. Ata po kërkojnë pagën e plotë dhe kompensimin e orëve jashtë orarit.



FJALEKRYQI SOT

1	2	3			4	5	6			7	8	9	10		11
12				13						14					
15			16					17						18	
		19					20						21		
	22					23						24			
25					26						27				
28				29						30					31
32			33						34						35
		36						37					38		
39							40						41		

HORIZONTAL

1- Vrapon 4- Litar çeliku 7- Lumi që kalon përmes Fierit 12- Koço, dirigjent 13- Regjizori durrsak Haxhi ... 14- Me këtë emër njihet më parë Egjipti i sotëm 15- Një vepër humoristike nga Molieri 17- Vend i rregulluar para portës së shtëpisë për të ndenjur 18- Humoristi anglez Atkinson në inic 19- Një shtet evropiano- lindor 20- Një lloj si kapriço 21- Është figurë gjeometrike 22- Tip autoveture ruse 23- Ato mund të jenë elektromagnetike 24- Lera i shkrimeve 25- Këlysh qeni 26- Aktori amerikan Bedi 27- Janë konstruksione prej betoni për ndërtim 28- Profil metalik 29- Akulllore e ngrirë 30- Zamira aktore 32- U rrëzua 33- Kafshë e vogël pa shtyllë kurrizore 34- Përmbledhje krijimesh letrare që botohen si vjetar 36- Koriqe, vend me drurë e shkurre të dendura 37- Mori anën e dikujt 38- Stacioni televiziv ... Neës 39- Hajat shkodran 40- Një shtet në gadishullin arabik me kryeqytet Muskat 41- Heroina Peza, mbrapsht.

VERTIKAL

1- Mimoza, këngëtare popullore 2- Tenor, pa qoshe 3- Njeri i prapë, i pashtruar, që sillet ashpër me të tjerët 4- Vegël metalike për prushin në oxhak 5- "Bel ...", një roman nga Mopasami 6- Vend i cekët ku mund të kalohet lumi 7- Një lloj si ves, zakon apo huq 8- Musliu regjisor 9- Legjendë, gojëdhënë 10- Flori 11- Ish Cari i tmerrshëm rus 13- Ndryshimet që pëson emri gjatë lakimit 14- Guri i mullirit 16- Dele me lesh të dredhur 17- Një fshat i thellë në veri të Tiranës 18- Një shpend shtëpiak femër 20- Letër në format të madh 21- Fjetore ushtarake 22- Një nder shfaqet e para të baletit shqiptar 23- Vend i varur nga ana administrative nga një tjetër që e ka mundur gjatë luftës 24- Një komedi e Shekspirin "... e dymbëdhjetë" 25- I vogli i gomaricës 26- Plëndësi i pulës 27- Shërbim i fshehtë ushtarak italian gjatë luftës 29- Një shtet ishull në Detin e Karaibeve 30- Një telenovelë me personazh Lukas 31- Nuk disponoj 33- ... Spencer 34- Ish aktorja italiane Manjani 35- Kafshë e egër e pyjeve tona 36- Zyrrat Ruse 37- Mamaqi e letrave në inic.

SUDOKU

5		6	7	3				4	3	1			6	7		2		6					5			8
7		4											2			4	7		2		8		6		1	
		3	9					6	2										4					9		
					5	1						8			7			2			6	8	1			
	3	7				8	5		9	1					3	8					7					
		2	8							7			5						3	7	5					
	8				6	3											2	7				2		4		
						4	7		7	6		9						8		5	3				7	
4				2	3	6		5		2		7	8			5	1							8		

Will Smith performon këngën e re "You Can Make It"

Will Smith iu rikthye muzikës. Ai performoi këngën e tij të re në spektaklin e ndarjes së çmimeve "BET Awards" (Black Entertainment Television). Smith ju rikthye muzikës me këngën "You Can Make It". Performanca e tij në "BET Awards" vjen pas shfaqjes që pati në muajin prill në festivalin "Coachella", kur doli në skenë përgjatë performimit të artistit J Balvin, për të interpretuar këngën e famshme "Man In Black", e cila për herë të parë ishte lançuar në vitin 1997 si kolonë zanore e filmit me po të njëjtin emër, shkruan CNN. Performanca e tij u konsiderua e suksesshme nga njohësit e fushës. Këngëtarë Teddy Swims më parë pat bërë të ditur se ka shkruar një këngë me Will Smithin, por që nuk e dinte kur do ta lançojë. Përgjatë viteve të fundit, Smith ka realizuar bashkëpunime me artistë të ndryshëm.



Balerinat

Duke ndjekur një shfaqje të bukur artistike, dy shokë komentojnë me njëri-tjetrin pasi ishin mërzitur nga baleti që kishte kohë që kishte filluar por nuk po përfundonte. I pari: - Pse balerinat vallëzojnë në majë të gishtave? Shoku tjetër përgjigjet: - Për të mos e zgjuar publikun nga gjumi!

Sëmundja e pijanecit

Pasi u vizitua nga mjeku, burri para se të largohej nga ambulanca i thotë mjekut: - Doktor të lutem çfarë sëmundje kam? Mjeku ia shpjegon: - Ti pi shumë dhe punon pak. Burrit nga që nuk i pëlqyen këto fjalë, i thotë sërish mjekut: - Të lutem doktor, mund të ma thuash emrin e sëmundjes në latinisht, që t'ia them gruas?

kulturë

Katër rosa të bllokuara në një kanalizim në Pensilvani u shpëtuan. Rosat u shpëtuan nga një ekip i zjarrfikësve. Kompania Quarryville Fire tha se një ekuipazh iu përgjigj një raporti për rosat që ranë në një kanal. "Vullnetarët ishin në gjendje të hynin në kanalet dhe të hiqnin katër rosat e vogla", deklaruan zyrtarët e zjarrit. Bëhet e ditur se zjarrfikësit nuk ishin në gjendje të gjenin nënën e rosave, kështu që ata i dërguan katër të tjerat në një qendër lokale të rehabilitimit të kafshëve.

Pensilvani, zjarrfikësit shpëtojnë katër rosa



Përgjigjet e fjalëkryqit

P	E	S	H	K		E	T	A	P	E
O		B	A	R	I	T	O	N		P
R	B		K	O	R	I	K		M	O
T	I	M		L	A	K		P	O	P
A	N	E	T		K	E	S	U	L	E
	A	T	O	M		T	U	R	E	
A	R	A	M	I	6/S		L	O	K	E
R	E	N		L	4/A	K		T	U	R
M	T		K	A	8/T	A	R		L	O
A		K	A	N	1/I	B	A	L		S
T	E	S	T	I		A	M	A	N	I

Rregullorja e BE dhe teknologjia e baterive nga Apple

Apple mund të prezantojë teknologjinë e re të baterive më shpejt. Rregullorja e re e BE përcakton që deri në vitin 2027 të gjitha pajisjet e vogla smart, si celularët të kenë bateri të zëvendësueshme. Aktualisht, iPhone përdor shiritat ngjitësi për të mbajtur në vend baterinë, një proces për të cilin duhet një pajisje e veçantë për heqjen e saj. Për t'iu përmbytur rregullores së re, Apple planifikon të implementojë një teknikë që do të përdorë një energji të vogël elektrike për të nxjerrë baterinë. Për këtë metodë ka pasur spekulime që vjet.

Fjalëkryq i shifruar

2	7	11	1	8		11	10	8	7	2
15		13	8	3	8	7	2	6		6
2	1		9	8	1	2	6		3	8
3	14	7		7	5	3		16	8	1
5	7	5	9		6	11	3	8	7	5
	2	6	11	6		7	2	4	5	
9	3	11	12	5	9/5		12	2	3	5
4	11	7		13	2/A	3		6	11	3
2	7		15	8	7/R	2	3		7	2
12		10	8	12	5/I	4	2	6		12
2	4	5	12	5		8	12	8	6	5

1			2	3		4	5			6
			7		8					
		9						10		
11	12			13				14	15	
16			17				18			
	19					20				
21					22					
23				24						25
26			27						28	
		29						30		
	31						32			
33						34				
35					36		37			38
39					40		41		42	
		43	44				45			
			46							
47							48			

HORIZONTAL

1- I thonë plëndësit të pulës 4- I zotërojmë 7- Kryeqyteti i një shteti në veri të Afrikës 9- Mbetje 11- Njëlloj si egoja 13- Veshje e priftit, pa të fundit 14- Stacioni ndërplanetar rus në hapësirë 16- Kuçedër 18- Ngjyrë blu e mbyllur 19- Ai i Pojanit, pa fund 20- Tas i thellë për çorbë 21- Aktorja italiane Laura ... 22- Figurë përrallore gjysmë peshk e tjetra femër 23- Shkrimtari dhe poeti kosovar Podrimja 24- Mali i ..., plazh afër shkëmbit të Kavajës 26- Notë në pentagram 27- Erë e fuqishme dhe shkatërrimtare 28- Lumë në veri të Italisë, në Lombardi 29- diku atje tej 30- Gazeta që ke në dorë 31- Ndryshe për mbledhjen 32- Ish-futbollisti i Tiranës Leonard ... 33- Cipa e kokërrdhokut të syrrit 34- Një shtet amerikano-latin me kryeqytet Lima 35- Parcelë e mbjellë 37- Njëra stinë e vitit 39- Lokal, kafe ... 40- Shkrimtari gjerman Thomas ... 42- Çdo ligj e ka një të tillë 43- Medikament për diabetikët 46- Ajo përcakton normat e sjelljes 47- Kështu quhej më parë vendi ynë 48- Ish-shahisti kampion durrsaku Fatos ...

VERTIKAL

1- Ish-aktori Avni ..., pa fund 2- Teket pa anë 3- Pepino di ... ish-këngëtar italian, pa fund 4- Një opera nga kompozitori Pjetër Maskanji 5- Një lloj peshku deti me trup shpatuk 6- Gadishull në jug të Europës 8- Një shtet fqinj me Irakun 9- Ultësira të pafund në Kinën Qendrore 10- Porosi e fundit 12- Lloj çokollate për të lyer bukën 15- Shkrimtari rus Turgenjev 17- Fringo fare, i porsadalë nga fabrika 18- ... Barleti 20- I thatë, lungë me qelb 21- Një qytet 22- Vend i rregulluar para portës së shtëpisë për të ndenjur 24- Diçka që ndjek të njëjtën rrugë veprimi pa ndryshim, gjithmonë njëlloj 25- Ish-mjeku Arqile ... 27- Lumi që kalon përmes Londrës 28- Brekushe 29- Lëndë, ndryshe i thonë ... 30- Njëlloj si nr 22 horizontalisht, por i shquar 31- Shtretër të ngrohtë për rritjen e perimeve 32- Jashin, ish-portieri legjendar rus 33- Është kryeqyteti i Marokut 36- Një shtet afrikan me kryeqytet Bamako 38- Mungesë e theksuar gjaku 40- Aktorja amerikane Ornella ... 41- Stadiumi ... Dovana 44- Një zotëri anglez 45- Bëri bujë, la ...

HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI

Dashi
21 mars - 20 prill
Dita e sotme nuk ka për të qenë aspak e mirë për ju. Herë pas here do gjendeni edhe në vështirësi.

Demi
21 prill - 21 maj
Hëna do ju shtojë imagjinatën gjatë kësaj dite dhe kjo gjë do ju ndihmojë të zgjidhni disa vështirësi që keni pasur.

Binjakët
22 maj - 21 qershor
Situata financiare do jetë e vështirë. Më mirë ulni tani shpenzimet se sa të ngelni më vonë pa asnjë para në xhep.

Gaforrrja
22 qershor - 22 korrik
Dita e sotme do jetë e mbushur me entuziazëm për të gjithë. Do i kushtoni shumë rëndësi jetës tuaj sentimentale.

Luani
23 korrik - 22 gusht
Do jeni mjaft entuziastë dhe dinamikë gjatë gjithë kësaj dite, kështu që gjërat do ju ecin përgjithësisht mirë.

Virgjëresha
22 gusht - 22 shtator
Në punë do i bëni gjërat sipas rregullave dhe nuk do anashkaloni asgjë. Gjithçka do ju ecë perfekt.

HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI

Peshorja
23 shtator - 22 tetor
Në punë duhet të tregoni më kujdes te projektet që ju keni. Në planin financiar nuk do keni përmirësime.

Akrepi
23 tetor - 21 nëntor
Në punë duhet të jeni të qartë para se të hidhni çdo lloj hapi. Vendimet e mëdha merrini pasi të konsultoheni me ata tek të cilët besoni.

Shigjetari
22 nëntor - 21 dhjetor
Dashuritë e reja janë mjaft të favorizuara veç kujdes për ata që janë të përfshirë në histori të vjetra, të cilat duhen mbyllur.

Bricjapi
22 dhjetor - 21 janar
Dielli do ju bëjë më të vendosur sot dhe plot vullnet për të çuar deri në fund projektet që keni nisur.

Ujori
22 janar - 19 shkurt
Në punë do punoni si duhet dhe arritjet do shihen. Buxhetin sërish nuk do arrini dot ta mbani nën kontroll.

Peshqit
20 shkurt - 20 mars
Kjo ditë do jetë herë pas here e trazuar për ju. Do ndesheni me persona intrigues e ziliqarë që do ua prishin humorin.

Franca kualifikohet ndaj Belgjikës me një autogol, ishte ndeshja më e bukur e 1/8 të finales

Francezët bënë ndeshje të fortë, por hasën në vështirësi pasi belgët bënë superndeshje. Por me një autogol në të 85' të belgëve përfitojnë e shkojnë më tej francezët

Adriatik BALLA

Dje u luajtën dy takime të 1/8 e finales që dhuruan emocione dhe spektakël, por edhe autogol që e konfirmojnë këtë European si më të spikaturin në këtë drejtim. Francë-Belgjikë ishte një nga duelet më të forta dhe emocionuese. Franca dje pasdite e mposhti 1:0 Belgjikën. Ndeshja me ritëm të lartë, e zhvilluar në Dusseldorf, u vendos nga një autogol. Në minutën e 85-të francezët realizuan një aksion të gjatë. N'Golo Kante pasoi bukur në zonë për rezervistin Randal Kolo Muani. Ai gjuajti, ndërsa rrugës për në portë sferën e devijoi mbrojtësi belg i qendrës, Jan Vertonghen. Në pjesën e dytë u luajt futbolli thujse më i mirë deri më tani në Evropianin në Gjermani. Raste kishte në të dy përfaqësueset, madje shumë të mira. Pak para golit të Francës, Kevin De Bruyne i Belgjikës



gjuajti bukur, por portieri i Francës, Mike Maignan bëri pritje vendimtare. Pas golit, belgët u hodhën në sulm, por francezët me përvojë nuk e rrezikuan fitoren. Kilian Mbape, që luajti sërish me maskë, ishte aktiv dhe i rrezikshëm gjatë tërë ndeshjes. Por në fund vendosi autogoli. Franca ka krijuar plot 20 raste, ndërsa Belgjika i kishte pesë. Por 16 prej goditjeve të

francezëve ishin të pasakta. Goditje në kornizë të portës, Franca e kishte vetëm një, kurse Belgjika dy. Franca llogaritet prej favoriteve për ta fituar Evropianin, por në fazën grupore nuk ka bindur me paraqitje. Dukshëm nivel më të lartë shfaqti ndaj Belgjikës. Edhe Belgjika është llogaritur në mesin e pretendenteve, por ka dëshpëruar me paraqitje. Franca e luan ndeshjen

çerekfinale më 5 korrik në Hamburg. Ndërkohë, një nga lojtarët e rëndësishëm të përfaqësueses së Francës duket se do të largohet nga Italia e do të përfundojë në Turqi. Kështu, Adrien Rabiot ka dalë lojtar i lirë pas përfundimit të kontratës me Juventusin, ekip ku mesfushori francez kaloi 5 sezonet e fundit. Klube si Milani apo Manchester Junajtid kanë shprehur interesim konkret për Rabiot, i cili pritet të largohet nga Serie A. Shtypi sportiv turk raporton lajmin e bujshëm që Galatasaray ka plotësuar pretendimet financiare të 29-vjeçarit. Duke gjetur gjuhën e përbashkët me përfaqësuesit e lojtarit në lidhje me termat personale të kontratës. Dhe kampionët e Turqisë po merren me detajet e fundit, për ta prezantuar më pas Rabiot si përforsimin ideal për mesin e fushës. 47 ndeshje numëron futbolli me kombëtaren e Francës, pjesë e së cilës është edhe në Gjermani-2024.

Sulmuesi/ Bellingham rrezikon ndeshjen me Spanjën, shkak sjellja ndaj Sllovakisë

UEFA ka nisur hetimet për Bellingham, pas gjestit të tij të dukshëm drejtuar stolit të Sllovakisë në fitoren dramatike të Anglisë në "EURO 2024". Anglia mundi Sllovakinë 2-1 të dielën për të siguruar vendin e tyre në raundin tjetër të turneut. Jude Bellingham shënoi një gol spektakolar me roveshatë, dhe çoi ndeshjen në shtesë, e që më pas anglezët e fituan me golin e shënuar nga Herri Kejn. "Organi i Kontrollit, Etikës dhe Disiplinës

UEFA (CEDB) do të vendosë mbi çështjen në kohën e duhur. Po ashtu, një hetues i Etikës dhe Disiplinës së UEFA do të kryejë një hetim disiplinor në lidhje me një shkelje të mundshme të rregullave bazike të sjelljes së mirë nga lojtari i Federatës së Futbollit të Anglisë, Jude Bellingham, e cila thuhet se ka ndodhur në këtë ndeshje. Informacioni në lidhje me këtë çështje do të jetë i disponueshëm në kohën e duhur", shkruan UEFA.



SULMUESI

Uilliams, "ylli" i Evropianit që kërkohet nga të gjithë



Për shkak të moshës dhe klubit, sulmuesi i krahut i Spanjës dhe Barcelonës, Lamine Jamal, ka rënë në sy gjatë "Euro 2024". Por në krahun tjetër të sulmit të Spanjës, Niko Uilliams po shfaqet si shkatërrues. 21-vjeçari i Athletic Bilbaos është vendimtar te "La Roja". Ai shënoi një gol mjeshtëror në fitoren 4:1 të Spanjës ndaj Gjeorgjisë në një të tetën e finales


në "Euro 2024". Tani Spanja luan ndaj Gjermanisë në çerekfinale. Gazeta e madhe spanjolle "Marca" i cilësoi Jamal dhe Uilliamsin sy dy Ferrari në krahë. "Ata të dy janë pjesë shumë e rëndësishme e skuadrës sonë", tha mesfushori Rodri, që shënoi pas asistimit të Uilliamsit për 1:1. i lindur pesë vjet e një ditë para Yamalit, Uilliams mund të transferohet në një ekip

të profilit më të lartë këtë verë. Ai është në radarin e Barcelonës për kohë të gjatë dhe nëse klubi katalunas avancoon financiarisht në javët e ardhshme, atëherë mund të bëjë lëvizjen për të bashkuar dyshen e selektorit Luis de la Fuente. Spanja po shpreson për triumfin e katërt në Evropian, ndërsa mbështetet shumë në lojën e mahnitshme në krah të Jamalit dhe Uilliamsit.

QËNDRIMI

Rudiger më i miri te Gjermania, por ai lavdëron grupin

Antonio Rudiger ishte lojtari më i mirë i ndeshjes mes Gjermanisë e Danimarkës (2-0). Ndaj Danimarkës pati ndërhyrje të mira dhe së bashku me mbrojtësin Niko Shloterbek ndihmuan që Gjermania të mos pësojë gol. Për Rudigerin sukcesi i arritur të shtunën është meritë e të gjithë futbollistëve. "Të gjithë e respektojnë punën e tyre. Unë mendoj se kjo është gjëja më e rëndësishme, që të gjithë luftojnë për njëri-tjetrin. Për ne është



e rëndësishme të punojmë si ekip dhe jo si individë. Të gjithë ata që më njohin mua e dinë që jam emocional në fushë", tha ai.

SURPRIZA

Batshuaji provon emocionet e të tre klubeve të Stambollit

Miki Batshuaji është lojtari i ri i Gallatasarait. Ai ka firmosur me gjigantin turk për tri vjet. Batshuaji do të ketë pagë prej 3 milionë euro në vit, ndërsa në emër të transferimit do të përfitojë 1,5 milionë në edicionin e parë, 1 milion në edicionin e dytë dhe 500 mijë euro në edicionin e tretë. Batshuaji bëhet lojtari i parë i huaj që luan për tri skuadrat e mëdha të Stambollit. Belgu 30-vjeçar, sulmues, ishte te Fenerbahçe, ndërsa më



parë ka luajtur edhe për Beshiktashin. Më herët u raportua për kërcënim me jetë të tij për shkak të kalimit te Gallatasarai.

BEFASIA

UEFA ndryshon disa rregulla, hyjnë në fuqi sezonin e ri

UEFA ka ndryshuar disa rregulla që lidhen me futbollin. "Në rast të një tronditjeje të trurit, mund të ketë një ndryshim të gjashtë. Jo çdo prekje me dorë që pengon një rast të qartë dhe të dukshëm do të jetë karton i kuq: do të ndëshkohet me penallti dhe karton të verdhë. Penalltia do të përsëritet vetëm nëse lojtari që hyn në zonë ka ndikim në rezultatin përfundimtar të aksionit. Në goditjet nga këndi, topi në momentin e gjuajtjes së



një penalltie duhet të jetë në qendër të pikës. Në penallti, topi duhet të jetë në kontakt me qendrën e pikës", shkruan UEFA.